



BRENDA PAK KOHËSH DO TË ORGANIZOHET NJË TRYEZË E PARTIVE POLITIKE
PËR POZITËN E PRESIDENTIT

FAQE 4-5

PARALAJMËROHET TRYEZA E PARTIVE PËR PRESIDENTIN



Së shpejti do të fillojnë përpjekjet e koalicionit qeverisës për gjetjen e një zgjidhje për pozitën e presidentit. Kryeministri Avdullah Hoti ka paralajmëruar të enjten se do të organizohet një tryezë me të gjitha partitë politike për të parë nëse ka vullnet që të gjendet zgjidhja për pozitën e presidentit. Sipas tij, në këtë tryezë do të shqyrtohen propozimet e partive politike. Ndërsa njohësit e rrethanave politike i kanë ftuar subjektet politike që të bëjnë një marrëveshje për zgjedhjen e presidentit të ri

22 TË VDEKUR PËR 24 ORË NGA COVIDI NË KOSOVË

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK) ka njoftuar të enjten se gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë janë regjistruar edhe 22 vdekje nga Covid-19. Sipas raportit të IKShPK-së, bazuar në testimin e 1 510 mostrave, janë konfirmuar të infektuar me Covid edhe 627 persona. Ndërkaq Qendra Klinike dhe Universitare e Kosovës (QKUK) ka pranuar të enjten një donacion nga UNOPS-i me 38 mijë maska dhe 15 mijë e 500 rroba mbrojtëse

FAQE 3



LIGJI PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NUK PO ZBATOHET NË KOSOVË



Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë thënë të enjten se institucionet e vendit kanë dështuar që t'i krijojnë kushtet themelore për personat me nevoja të veçanta. Sipas tyre, Ligji për Personat me Aftësi të Kufizuara nuk zbatohet as nga institucionet private as nga ato publike. Numri i personave me nevoja të veçanta në Kosovë është rreth 200 mijë

FAQE 5

OPINION

A DO TË SHPËRTHEJË
LUFTA E TRETË BOTËRORE
QË LDK-JA HUMBI
ZGJEDHJET NË PODUJEVË

F. 10

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



AKTUALE



TRUMPI PRETENDON SËRISH SE
ZGJEDHJET E 3 NËNTORIT JANË
MANIPULUAR

F. 2

SITUATA E SIGURISË NË
KOSOVË, E QETË

F. 4

EKONOMI

ÇMIMET E IMPORTIT
SHËNUAN NGRITJE

F. 9

OEAK-U DHE OEK-U
MIRËPRESIN PËRAFRIMIN E
QËNDRIMEVE RRETH
PROJEKTLIGJIT PËR
RIMËKËMBJE EKONOMIKE

F. 9

SPORT

PRISHTINA KËRKON FITORE NË
DERBIN NDAJ FERONIKELIT

F. 12



RENOVA
PUTZ

Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177

www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com

038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Trumpi pretendon sërish se zgjedhjet e 3 nëntorit janë manipuluar

WASHINGTONI, 3 DHJETOR - Presidenti amerikan Donald Trump ka publikuar një material 46-minutësh, duke ricikluar pretendimet e tij të pabazuara për mashtrime zgjedhore, në zgjedhjet që ka humbur muajin e kaluar kundër sfiduesit demokrat, Joe Biden. Në një video të publikuar në rrjetin social "Facebook", Trump e ka quajtur fjalimin ndoshta "më të rëndësishmin që kam bërë ndonjëherë", teksa ka sugjeruar se Gjykata Supreme duhet "të bëjë atë që është mirë për shtetin tonë" dhe ta përmbyset rezultatin. Presidenti 74-vjeçar ka

vazhduar të vë në pikëpyetje rezultatet që kanë treguar se Bideni ka fituar një rekord prej 81 milionë votash në zgjedhje, apo 7 milionë më shumë sesa Trumpi. Megjithatë, presidenti amerikan ka thënë se zgjedhjet janë manipuluar, ndonëse anëtarët e administratës së tij, duke përfshirë aleatin e tij të afërt, prokurorin e përgjithshëm William Barr, kanë përsëritur se nuk ka dëshmi për mashtrime zgjedhore. Asnjë pjesëtar i mediave nuk është parë në incizimin e Trumpit. Fushata e Trumpit dhe

mbështetësit e tij kanë dërguar në gjykatë disa raste dhe kanë pretenduar se janë kryer keqbërje në zgjedhjet e nëntorit, ndonëse pothuajse të gjitha janë hedhur poshtë për mungesë të provave. Ndonëse "Facebook" dhe "Twitter", ku Trump ka postuar linkun e videos, e kanë shënjuar materialin si problematik, qindra mijëra mbështetës të tij "e kanë pëlqyer" videon. Bideni ka vazhduar ta ndërtojë administratën e tij për ta nisur udhëheqësinë në Shtëpinë e Bardhë, pas inaugurimit më 20 janar. "Ekipi im për tranzicion është duke punuar për atë që do



të çojë përpara në Kongres, për të adresuar shumë kriza me të cilat po përballemi, sidomos krizën ekonomike dhe

koronavirusin", ka thënë Biden para punëtorëve në një tryezë të rrumbullakët në vendlindjen e tij në Delaue më 2 dhjetor.

Qeveria afgane dhe talibanët arrijnë marrëveshje 'historike' në bisedimet për paqe



KABUL, 3 DHJETOR - Zyrtarët e qeverisë afgane dhe përfaqësuesit e talibanëve kanë thënë se janë pajtuar në parim për një marrëveshje të zhvillimit të bisedimeve për paqe. Kjo njëherësh përbën marrëveshjen e tyre të parë të shkruar në 19 vjetët e fundit të luftës. Njoftimi i 2 dhjetorit është konsideruar pikë kthese sepse u jep negociatorëve më shumë kohë për të kaluar në çështje më substanciale. Aty përfshihen bisedimet me

qëllim të arritjes së armëpushimit. "Negociatat aktuale të të dyja palëve negociatore tregojnë se ka gatishmëri në mesin e afganëve për të arritur paqe substanciale dhe të dyja palët janë të përkushtuara për t'i vazhduar përpjekjet e tyre të sinqerta për të arritur paqe të qëndrueshme në Afganistan", ka thënë Nader Nadery, anëtar i ekipit negociator nga ana e qeverisë afgane. Një përfaqësues i talibanëve ka publikuar

pothuajse deklaratën e njëjtë në rrjetin social "Twitter". Në deklaratën e tyre të përbashkët është thënë "të jetë caktuar një komitet i përbashkët për t'i përgatitur temat e agjendës" për bisedime të paqes. Kjo marrëveshje vjen pas disa muajsh të bisedimeve në kryeqytetin e Katarit, Doha. Të dyja palët vazhdojnë të jenë në luftë, meqë sulmet e talibanëve ndaj forcave të qeverisë afgane janë duke vazhduar.

OKB-ja paralajmëron se prodhimi i lëndëve djegëse po tejkalon synimet për klimën

NJU JORK, 3 DHJETOR - Një raport i ri ka paralajmëruar më 2 dhjetor se bota planifikon të prodhojë më shumë se dyfishin e sasisë së lëndëve të dëmshme djegëse deri më 2030, në krahasim me normat që janë në përputhje me frenimin e ngrohjes globale. Sipas Marrëveshjes së Parisit për Klimën, të vitit 2015, shtetet janë zotuar për një synim afatgjatë të kufizimit të temperaturës mesatare nën 2 gradë celsius mbi nivelet paraindustriale dhe të bëjë përpjekje për kufizim të temperaturës në 1.5 gradë celsius. Për t'u arritur synimi prej 1.5 gradësh celsius, prodhimi i thëngjillit, naftës dhe gazit duhet

të ulet për 6 për qind brenda një viti, për periudhën 2020-2030. Raporti i ri i Programit të Kombeve të Bashkuara për Ambient dhe ekspertë nga institute të ndryshme shkencore dhe universitete paralajmërojnë se planet qeveritare japin shenja për rritje vjetore prej 2-përqindësh të prodhimit të këtyre lëndëve. Një gjë e tillë, sipas raportit, do të rezultojë që, deri më 2030, të dyfishohet prodhimi që është në përputhje me kufizimet prej 1.5-gradësh celsius. Në një tjetër paralajmërim për ndryshimet klimatike, Organizata Botërore për Meteorologji, ka

thënë se vlerësimet e përkohshme sugjerojnë se viti 2020, ka qenë ndër vitet më të nxehta, pas viteve 2016 dhe 2019. Në një fjalim në Nju Jork, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres ka dënuar dështimin "vetëvrasës" për të luftuar ngrohjen globale, duke thënë se njerëzimi i ka shpallur luftë natyrës. "Biodiversiteti është duke u shkatërruar. Një milion gjallesa janë në rrezik të zhdukjes. Ekosistemet janë duke u zhdukur para syve tanë. Shkretëtirat janë duke u përhapur. Ligatinat janë duke humbur. Çdo vit ne humbim 10 milionë hektarë pyje",



ka thënë Guterres. Mirëpo ai ka thënë se rimëkëmbja nga pandemia e koronavirusit

mund të jetë mundësia e njerëzimit për të vepruar ndryshe, me qëllim të ruajtjes së planetit.



Vdes ish-presidenti francez Giscard d'Estaing

PARIS, 3 DHJETOR - Ish-presidenti francez Giscard d'Estaing, arkitekti kyç i integriteteve evropiane në vitet

1970, ka vdekur në moshën 94-vjeçare. Ai ka vdekur në shtëpinë e tij në rajonin Loiret-Cher në qendër të Francës,

pas komplikimeve të lidhura me koronavirus. Ai së fundmi ka qenë i shtrirë në spital në qytetin Tours. I njohur për

shumë francezë si Giscard apo VGE, presidenti liberal ka shërbyer në krye të shtetit në periudhën 1974-1981.

22 të vdekur për 24 orë nga Covidi në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK) ka njoftuar të enjten se gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë janë regjistruar edhe 22 vdekje nga Covid-19. Sipas raportit të IKShPK-së, bazuar në testimin e 1 510 mostrave, janë konfirmuar si të infektuar me Covid edhe 627 persona. Ndërkaq Qendra Klinike dhe Universitare e Kosovës (QKUK) ka pranuar të enjten një donacion nga UNOPS-i me 38 mijë maska dhe 15 mijë e 500 rroba mbrojtëse



QKUK-ja furnizohet me 38 mijë maska dhe mbi 15 mijë rroba mbrojtëse

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka njoftuar se Qendra Klinike dhe Universitare e Kosovës ka pranuar një donacion nga UNOPS. Donacioni përmban 38 mijë maska dhe 15 mijë e 500 rroba mbrojtëse. "Shtetet,

organizatat ndërkombëtare dhe institucionet e huaja në vendin tonë, në vazhdimësi po e ndihmojnë vendin tonë për menaxhimin e pandemisë. Jemi falënderues për secilën ndihmë dhe përkrahje. Qytetarët me disiplinë, por

edhe me institucionet për zbatimin e masave dhe mbikëqyrjes, do të arrijmë sukses, andaj ndryshoni sjelljen tuaj, për ta ndryshuar gjendjen në republikën tonë. Bashkë ia dalim!", ka shkruar Zemaj në llogarinë e vet në "Facebook".

(78 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 41 299 raste nga 148 213 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 062 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 543 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 26 453 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 13 784. Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 286 raste, Ferizaj 39 raste, Mitrovicë 33 raste, Fushë-Kosovë 29 raste, Pejë 28 raste, Drenas 26 raste, Podujevë 25 raste, Gjakovë 22 raste, Lipjan 19 raste, Gjilan 18 raste, Shtime 12 raste, Viti 12 raste, Prizren 11 raste, Deçan 8 raste, Malishevë 8 raste, Rahovec 8 raste, Klinë 7 raste, Obiliq 7 raste, Istog 5 raste, Vushtrri 5 raste, Skenderaj 4 raste, Hani i Elezit 3 raste, Kamenicë 3 raste, Kaçanik 3 raste, Suharekë 2 raste dhe me nga 1 rast komunat Dragash, Junik, Novobërdë dhe Shtërpçë.

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 510 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 627 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar 22 raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Prishtinë nëntë raste (87, 80, 79, 79, 79, 75, 74, 74, 60 vjeç), Mitrovicë dy raste (79, 77 vjeç), Prizren dy raste (82, 77 vjeç), Gjakovë dy raste (76, 60 vjeç), Istog dy raste (84, 65 vjeç), Rahovec dy raste (83,79 vjeç), Pejë një rast (72 vjeç), Klinë një rast (62 vjeç), Suharekë një rast

Hap i rëndësishëm në fillimin e bashkëpunimit bilateral në mes të Kosovës dhe EUROJUST-it

PRISHTINË, 3 DHJETOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka marrë pjesë të enjten në takim dhe parë bilateral dhe virtual në mes të Republikës së Kosovës dhe EUROJUST. Në këtë takim virtual, i cili kryesohej nga presidenti i EUROJUST, Ladislav Hamran, ministri Selimi ka treguar se sa e rëndësishme është vendosja e bashkëpunimit mes EUROJUST dhe Republikës së Kosovës. Të dy bashkëfolësit e konsideruan këtë si një hap historik për fillimin e bashkëpunimit me qëllim të vendosjes së marrëveshjes bilaterale në mes të Kosovës dhe EUROJUST. "Natyrisht rrjedh se ekziston një nevojë e domosdoshme, për EUROJUST dhe Republikën e Kosovës për të vendosur bashkëpunim si partnerë strategjikë, në mënyrë që ta forcojmë rrjetin tonë në luftën kundër krimeve të rënda

ndërkufitare. Autoritetet gjyqësore kosovare shpresojnë të përfitojnë nga mjetet praktike të bashkëpunimit të ofruara përmes EUROJUST, nga lehtësimi i ndihmës së ndërsjellë juridike, përdorimi i instrumenteve të njohjes reciproke dhe koordinimi i çështjeve penale", ka thënë Selimi. Në këtë frymë, ministri Selimi ka shprehur vullnetin e plotë të institucioneve të Kosovës për thellimin e bashkëpunimit në mes të shtetit të Kosovës dhe EUROJUST. "I nderuar president Hamran, kujtoj se EUROJUST tashmë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me të katër vendet fqinje të Kosovës. Bashkëpunimi mes institucioneve të drejtësisë shkon përtej politikës. Kosova me hapjen e këtij bashkëpunimi do të jetë pjesë e EUROJUST dhe një hap para integritimit euroatlantik. Vendosja e bashkëpunimit me



Kosovën gjithashtu, do të prodhonte rezultate më efektive dhe të qëndrueshme në luftimin e krimit të organizuar ndërkufitar në rajon. Prandaj, unë shfrytëzoj këtë mundësi për ta shprehur

interesimin tonë për t'i ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për të përfunduar një marrëveshje bashkëpunimi midis EUROJUST dhe Kosovës, e cila do t'i vendoste bazat për arritjen e

qëllimit tonë të përbashkët për drejtësi dhe siguri", ka deklaruar Selimi. Për herë të parë Republika e Kosovës është ftuar që të marrë pjesë në takimin bilateral virtual të EUROJUST.



BRENDA PAK KOHËSH DO TË ORGANIZOHET NJË TRYEZË E PARTIVE POLITIKE PËR POZITËN E PRESIDENTIT

PARALAJMËROHET TRYEZA E PARTIVE PËR PRESIDENTIN

Së shpejti do të fillojnë përpjekjet e koalicionit qeverisës për gjetjen e një zgjidhje për pozitën e presidentit. Kryeministri Avdullah Hoti ka paralajmëruar të enjten se do të organizohet një tryezë me të gjitha partitë politike për të parë nëse ka vullnet që të gjendet zgjidhja për pozitën e presidentit. Sipas tij, në këtë tryezë do të shqyrtohen propozimet e partive politike. Ndërsa njohësit e rrethanave politike i kanë ftuar subjektet politike që të bëjnë një marrëveshje për zgjedhjen e presidentit të ri

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka paralajmëruar se shpejt do të organizohet një tryezë me partitë politike për të gjetur një zgjidhje për presidentin e vendit. Shefi i ekzekutivit ka deklaruar se kjo tryezë do të organizohet së shpejti. "Do të ndjekim vetëm një zgjidhje kushtetuese. Unë besoj se shpejt do të organizohet tryeza e partive politike për të parë disponimin e tyre nëse janë të gatshme që të diskutojnë rreth gjetjes së një zgjidhje për presidentin e vendit", ka deklaruar Hoti, pas nënshkrimit të panos për zotim për gjithëpërfshirje, e cila u vendos në oborrin e Kuvendit të Kosovës.

Ai ka folur edhe për pretendimet e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për pozitën e presidentit. Hoti ka thënë se të gjitha opsionet do të diskutohen në këtë tryezë. "Nuk jemi ulur në tryezën e partive politike për të parë së pari a ka vullnet të zgjidhet një president dhe nëse ka vullnet, cilat janë propozimet e partive politike. E dimë propozimin e

AAK-së, tash po duket edhe të PDK-së. Besoj në ditët e ardhshme do të organizohet kjo tryezë dhe të shohim se si mund të shkojmë tutje. Është vështirë të them se vetëm në tryezë mund t'i gjejmë ato zgjidhje. Besoj se në ditët e ardhshme mund ta dimë", është shprehur Hoti.

PDK-ja dhe AAK-ja insistojnë për pozitën e presidentit

Pas AAK-së, edhe PDK-ja ka bërë me dije se do ta kërkojë pozitën e presidentit. Një ditë më parë ushtruesi i detyrës i kryetarit të PDK-së, Enver Hoxhaj, ka bërë me dije se kjo parti është e gatshme të bisedojë për çështjen e presidentit me partitë në pushtet. Ai ka deklaruar se ky subjekt politik nuk do ta mbështetë asnjë kandidat për president, i cili vjen nga partitë në pushtet. "Që ta kuptoni drejt qasjen tonë, PDK-ja është në opozitë, mbetet në opozitë, por janë 4-5 tema të cilat janë të karakterit nacional, ku kërkohet konsensus nacional. Një temë e tillë është edhe pakoja e rimëkëmbjes ekonomike. Tema e dytë është edhe zgjedhja e

presidentit. Presidenti i cili zgjidhet në Kuvendin e Kosovës nuk është vetëm president i partive që janë në qeveri, i shumicës parlamentare. Ai është president edhe i opozitës dhe i të gjithë qytetarëve të Kosovës", ka thënë Hoxhaj.

Ai ka treguar se nëse partitë në pushtet i kërkojnë votat e PDK-së për këtë çështje, atëherë kandidati për president duhet të jetë nga kjo parti. "Prandaj, nëse ka kërkesa prej kolegëve që janë në qeveri që ta marrin mbështetjen e PDK-së, ne jemi të gatshëm që të ulemi dhe të bisedojmë. Por në atë rast, kur kërkohen votat e PDK-së, edhe kandidati duhet të jetë i Partisë Demokratike të Kosovës. Ne e dimë se presidenti i vendit është kreu i shtetit, por ju e dini se këtë mandat e ka pasur presidenti Thaçi, i cili, në të kaluarën, ka qenë kryetar i PDK-së, që ka hequr dorë prej kryetarit të partisë dhe është bërë president i vendit. Dhe nëse dikush kërkon mbështetje të PDK-së, duhet ta dijë se Gjykata Speciale ia ka ndërprerë atij mandatin dhunshëm dhe ne duam që me vota të PDK-së ky mandat t'i takojë PDK-së. Nuk kemi vota për asnjë kandidat që vjen prej partive në pushtet", ka deklaruar Hoxhaj.

Edhe zyrtarët e AAK-së kanë bërë me dije se do ta votojnë vetëm kandidatin e tyre për president, që është Ramush Haradinaj. Sipas tyre, nëse lideri i kësaj partie, Ramush Haradinaj, nuk zgjidhet president, vendi mund të shkojë në zgjedhje. Kurse partia më e madhe në vend, LV-ja, ka bërë me dije se çështja e presidentit duhet të diskutohet vetëm pas zgjedhje të përgjithshme.

Partitë të bëjnë kompromis për pozitën e presidentit

Njohësit e rrethanave politike në vend dhe disa deputetë kanë theksuar se për pozitën e presidentit duhet të bëjnë një kompromis të gjitha subjektet politike parlamentare. Analisti politik Behxhet Shala ka thënë për "Epokën e re" se subjektet politike duhet të ulen dhe ta arrijnë një marrëveshje këtë çështje sa më shpejt. "Realisht e kemi një situatë politike e cila kërkon zgjidhje. Sipas meje, partitë politike duhet të ulen dhe të bëjnë përpjekje për ta zgjedhur presidentin. Në qoftë se nuk arrijnë një marrëveshje procedurale për presidentin, atëherë partitë politike do të duhej të merren vesh për datën e zgjedhjeve, të cilat do të duhej të mbaheshin jo më herët se në muajin qershor të vitit 2021", ka thënë Shala. Edhe deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Fatmir Rexhepi, ka ftuar liderët e të gjitha partive politike që të gjejnë një kompromis për

pozitën e presidentit. Ai ka deklaruar për "Epokën e re" se zgjedhja e presidentit të ri është çështje që iu takon të gjitha partive politike. "Mendoj se të gjitha partitë politike parlamentare duhet të ulen dhe të arrijnë një marrëveshje politike për zgjedhjen e presidentit. Duhet ta ndajmë çështjen e presidentit prej qeverisë. Çështja e presidentit nuk duhet të përzihet me çështje të tjera, sepse kjo do të na riciklojë sërish krizën për presidentin. Ftoj liderët e të gjitha partive që të ulen dhe ta bëjnë një kompromis për pozitën e presidentit. Të gjithë e kanë për borxh që ta gjejnë një presidenti konsensual", ka deklaruar Rexhepi. Sipas tij, partitë politike vetëm bashkërisht mund ta zgjidhin këtë çështje. "Partitë politike duhet të ulen dhe të merren vesh edhe për zgjedhje. Të merren vesh nëse ato duhet të mbahen në pranverë, pas gjashtë muajve apo pas një viti. Me rëndësi është që çështjen e presidentit duhet ta heqim nga rendi i ditës bashkërisht. Edhe pas zgjedhjeve të reja duhet të ulemi dhe ta bëjmë të njëjtën procedurë. Tani Kuvendin e kemi legjitim dhe partitë politike duhet të gjejnë zgjidhje për presidentin", është shprehur ai. Partnerët e koalicionit kanë edhe pesë muaj kohë për arritjen e pajtimit për zgjedhjen e presidentit të ri të vendit, post ky që u bë pjesë e kalkulimeve politike pas konfirmimit të aktakuzës për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, ndaj ish-presidentit Hashim Thaçi, i cili dha dorëheqje më 5 nëntor.

Fëmijët me aftësi të kufizuara mbështeten me 800 tabletë për t'ua lehtësuar mësimin në distancë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Kriza globale e shkaktuar nga Covid-19 po i thëllon pabarazitë që kanë ekzistuar edhe në të kaluarën, duke ekspozuar shkallën e përjashtimit dhe duke vënë në pah se puna për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara është e domosdoshme. Fëmijët me aftësi të kufizuara janë një nga grupet më të përjashtuara në shoqërinë tonë dhe janë ndër më të prekurit në këtë krizë për sa iu përket fataliteteve. Përhapja e Covid-19 ka ndikuar drejtpërdrejt në jetën e fëmijëve dhe familjeve të tyre në Kosovë. Ndikimi afatgjatë në shërbimet sociale që edhe ashtu kanë qenë të dobëta dhe në përgjithësi në shoqëri mbetet për t'u vlerësuar në tërësi.

Rreth 345 000 fëmijë në nivelet parashkollore, fillore dhe të mesme nuk e kanë vijuar mësimin në shkolla gjatë bllokimit, duke rezultuar kështu në një numër të fëmijëve që nuk mund ta ndjekin shkollimin për shkak të mungesës së teknologjive ndihmëse. Sipas të dhënave të vitit 2020, vetëm 53 për qind e familjeve në Kosovë kanë kompjuter ose tabletë. Si reagim ndaj kësaj situatë, si pjesë e marrëveshjes së nënshkruar midis Ambasadës Britanike dhe Ekipit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë për një seri ndërhyrjesh të integruara dhe gjithëpërfshirëse shëndetësore dhe arsimore, UNICEF-i do t'i dhurojë 800 tabletë për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe do ta mbështesë emërimin e 35 asistentëve të mësimdhënësve

për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Në fushën e arsimit projekti do të ofrojë mbështetje në aspektin e sigurisë së shkollave duke monitoruar respektimin e rekomandimeve për parandalim të Covid-19 në shkolla dhe duke ofruar mbështetje për fëmijët me nevojë të veçanta ose ata që janë në rrezik të braktisjes së shkollës.

Një fokus i veçantë i projektit do të jetë te gratë dhe vajzat e reja. Megjithatë fëmijët nuk janë grupi më i prekur i kësaj pandemie pasi që kryesisht janë kursyer nga efektet direkte klinike të Covid-19, kriza pandemike ka një efekt të madh në jetën dhe mirëqenien e tyre. Murat Sahin, shef i Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, ka theksuar se është rritur hendeku

i të mësuarit midis fëmijëve nga familjet më të pasura që ishin në gjendje ta vazhdonin mësimin në distancë përmes mjeteve digjitale dhe atyre nga familjet më të varfra që filluan të mbesin prapa në mësim. "Përkundër veprimeve të shpejta me mësimin në distancë, provat sugjerojnë se humbja në të nxënit për Kosovën do të jetë e pashmangshme dhe e konsiderueshme me ç'rast një pjesë e madhe e nxënësve do të bien në analfabetizëm funksional dhe do të ketë rritje të niveleve të braktisjes së shkollës. Në këtë aspekt, shqetësim specifik përbëjnë fëmijët me nevojë të veçanta", ka thënë ai. Ambasadori Britanik në Kosovë, Nicholas Abbott, ka pohuar se në Ditën Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, ka thënë se Mbretëria

e Bashkuar është e përkushtuar për ta ndryshuar jetën e atyre që janë ndër më të rrezikuarit në botë. Sipas tij, për t'i dhënë fund diskriminimit dhe stigmës kundër personave me aftësi të kufizuara dhe për të punuar drejt një bote më të përparuar, duke mos lënë askënd anash. Ndërkaq ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka theksuar që përfshirja e personave me aftësi të kufizuara duhet të jetë pjesë e agjendës sonë ditore për t'u siguruar që ata të gëzojnë të drejta të plota dhe të bëhen anëtarë të barabartë dhe produktivë të shoqërisë sonë. Ramë Likaj, ministër i Arsimit, ka theksuar mbështetjen e tij dhe të ministrisë që drejton rreth përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara që ta gëzojnë të drejtën e tyre në arsim.



Situata e sigurisë në Kosovë, e qetë

PRISHTINË, 3 DHJETOR (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ka pritur të enjten në takim njoftues komandantin e ri të KFOR-it, gjeneralmajorin Franco Federici. Ministri Veliu e ka uruar komandantin e ri, gjeneralmajorin Federici dhe ka theksuar se KFOR-i ka qenë dhe vazhdon të mbetet

institucioni më i besueshëm për qytetarët e Republikës së Kosovës. Të dy bashkëbiseduesit diskutuan për situatën e përgjithshme të sigurisë në vend, duke vlerësuar se momentalisht situata në aspektin e sigurisë është e qetë dhe stabile si dhe u diskutua për menaxhimin e pandemisë

Covid-19 me të cilën jemi duke u përballur.

Ministri Veliu dhe gjeneralmajor Federici theksuan se bashkëpunimi në mes të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe KFOR-it është shumë i mirë dhe shprehën gatishmërinë që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe më tutje.



Regjimenti i Dytë i Këmbësores së FSK-së përmbylli me sukses stërvitjen fushore 'Steel-02'

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

ISTOG, 3 DHJETOR - Në zonën stërvitore, afër kazermës së FSK-së "Ushtarët e NATO-s" në Istog, u realizua demonstrimi stërvitor përmbyllës i Kompanisë 2A të Regjimentit të Dytë të Forcave Tokësore të FSK-së në kuadër të stërvitjes fushore katërditore "Steel-02".

Për të parë nga afër demonstrimin e operacioneve stërvitore ishin ministri i Mbrojtjes, Anton Quni dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, të shoqëruar nga zyrtarë e oficerë të tjerë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të FSK-së. Në fillim ata u pritën nga komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneralbrigade Fadil Hadergjonaj dhe stafi i tij i cili falënderoi për vizitën duke e vlerësuar lart si shprehje e kujdesit permanent të lidhshpimit me ndikim të madh në motivimin për punë të suksesshme edhe në të ardhmen. Me këtë rast, komandanti i

Regjimentit të Dytë, nënkolonel Astrit Haliti dhe komandanti i Kompanisë 2A, kapiten Kreshnik Zeneli, njoftuan lidhur me qëllimin e stërvitjes, konceptin, njësitë e angazhuara, përbërjen e tyre, organizimin, skenarin, si dhe operacionet të cilat u ekzekutuan në stërvitjen përkatëse.

Pas demonstrimit stërvitor, pjesëtarëve të task-forcës pjesëmarrëse në stërvitje iu drejtua ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, i cili shprehu përshtypjet e tij për nivelin e lartë të profesionalizimit të demonstruar gjatë stërvitjes. "Demonstrimi juaj i sotëm më bënë shumë krenar dhe me besim të plotë se aftësitë dhe kapacitetet tuaja profesionale janë në nivelin më të lartë për t'u përballur me të gjitha kërcënimet dhe rreziqet e formave të ndryshme bashkëkohore e shumë komplekse që mund ta cenojnë integritetin e vendit dhe sigurinë e qytetarëve tanë", ka thënë ministri Quni.

Nga ana e tij, gjeneral Rama ka shprehur vlerësimin e lartë për nivelin e planifikimit dhe



ekzekutimit të kësaj stërvitje, duke theksuar se ky nivel i profesionalizimit të demonstruar është dëshmi e fuqishme se Kosova ka forca të ndërveprueshme për operacione të përbashkëta me forcat aleate. "Misioni ynë fisnik dhe detyrat tona kërkojnë mund, sakrificë

dhe përgjegjshmëri të lartë. Për këtë duhet të jemi gjithmonë të vetëdijshëm për të tashmen dhe të ardhmen e vendit duke kujtuar gjithmonë të kaluarën tonë dhe mbështetjen e partnerëve tanë", ka thënë gjeneral Rama.

Me këtë stërvitje përmbillet suksesshëm cikli i stërvitjeve të

planifikuara të Regjimentit të Dytë të Këmbësores për këtë vit dhe ishte aktiviteti i radhës i Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së në kuadër të procesit të zhvillimit të aftësive dhe kapaciteteve operacionale për mbrojtjen e territorit, si detyrim kryesor ligjor i saj.

Banorët e Krushës, të indignuar me uljen e dënimit ndaj Tasiqit

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Familjarë të personave të vrarë e të zhdukur nga Krusha e Madhe dhe Krusha e Vogël, por edhe banorë nga fshatra të tjerë, kanë protestuar të enjten para Pallatit të Drejtësisë në Prishtinë. Kjo protestë është zhvilluar pas përgjysmimit të dënimit ndaj Darko Tasiqit, njërit prej personave të dënuar për krime të luftës në Kosovë.

Protestuesit kanë thënë se ulja e dënimit është e papranueshme dhe veprim fyes nga ana e sistemit të drejtësisë. Shpresa Shehu, përfaqësuese e fshatit Krusha e Vogël, tha se, përveç vuajtjeve që kanë banorët, ata tash kanë edhe një brengë tjetër me vendimet e fundit nga gjykata. "Është bërë padrejtësia më e madhe që iu ka përgjysmuar dënimi kriminelit Darko Tasiq. Ne jemi të indignuar, jemi të shqetësuar e të mërzitur. Ai e ka pasur dënimin jo të mjaftueshëm me aq sa krime ka bërë në fshatin tonë dhe fshatrat e tjerë përreth", tha Shehu.



Disa nga përfaqësuesit e këshillit organizativ të protestës kanë hyrë në një takim me përfaqësuesit e Gjykatës së Apelit për të marrë shpjegime për uljen e dënimit. Gjykata e Apelit në Kosovë ka njoftuar të martën se e ka miratuar pjeshëm ankesën e të akuzuarit Darko Tasiq, lidhur me aktgjykimin e Gjykatës

Themelore të Prizrenit të datës 22 qershor 2020, sipas të cilit, ai është dënuar me 22 vjet burgim me akuzat për krime lufte kundër popullatës civile shqiptare.

Në vendimin e Gjykatës së Apelit është thënë se vendimi paraprak i gjykatës në Prizren është ndryshuar vetëm sa i përket cilësimit juridik të veprës penale

dhe vendimit mbi dënim.

Për pasojë, dënimi ndaj Tasiqit është ndryshuar nga 22 në 11 vjet burgim, duke përfshirë kohën e kaluar në paraburgim. Më 22 qershor të këtij viti, Tasiqi është shpallur fajtor për krime lufte ndaj popullatës civile në vitin 1999 në Krushë të Vogël të Prizrenit.

Sipas aktgjykimin të gjykatës në Prizren, Tasiqi ishte shpallur fajtor për pikën dy të aktakuzës për përdhosjen e trupave të pajetë të personave të paidentifikuar, duke i djegur ata dhe duke i hedhur në Lumin Drin.

Tasiqi ishte shpallur fajtor edhe për akuzën që thotë se në mars të vitit 1999 në Krushë të Vogël, si pjesëtar i forcave rezervë të Policisë së Republikës Federative të Jugosllavisë, në bashkëryerje me persona të tjerë, identiteti i të cilëve nuk është arritur të përcaktohet, Tasiqi ka marrë pjesë në konfiskim të pasurisë, plaçkitje, shkatërrim të paligjshëm dhe të qëllimshëm të pasurisë (djegien e shtëpive) që nuk justifikohet me nevojat ushtarake.

Darko Tasiqi pati mohuar fajësinë dhe është mbrojtur në heshtje. Sipas Fondit për të Drejtën Humanitare, gjatë konfliktit të viteve 1998-'99 në Kosovë janë vrarë më shumë se 13 500 persona.

Shtëpia e Bardhë në Prizren ndriçohet portokalli në mbështetje të fushatës 16 Ditët e Aktivizmit

Prizren, 3 dhjetor (ER) - Duke vazhduar me fushatën 16 Ditët të Aktivizmit kundër Dhunës në Baza Gjinore, mbrëmjen e së mërkurës UNDP-ja ka ndriçuar Shtëpinë e Bardhë në Prizren ngjyrë portokalli. Të pranishëm në ngjarje ishin

Maria Suokko, përfaqësuese e përhershme e UNDP-së, Niels Knudsen, zëvendëspërfaqësues i përhershëm, Neil Taylor, shefi i BERZh-it për Kosovë, dhe nikoqiri Mytaher Haskuka, kryetari i Komunës së Prizrenit. Ky i fundit ka

theksuar se duke e ndriçuar portokalli Shtëpinë e Bardhë, një ndërtesë në qendër të qytetit dërgon një mesazh të fuqishëm për ta rritur ndërgjegjësimin për 16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave.



Deputetët e Kuvendit të Kosovës diskutuan për problemet e personave me nevoja të veçanta

Ligji për Personat me Aftësi të Kufizuara nuk po zbatohet në Kosovë



Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë thënë të enjten se institucionet e vendit kanë dështuar që t'i krijojnë kushtet themelore për personat me nevoja të veçanta. Sipas tyre, Ligji për Personat me Aftësi të Kufizuara nuk zbatohet as nga institucionet private as nga ato publike. Numri i personave me nevoja të veçanta në Kosovë është rreth 200 mijë

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Shteti i Kosovës ka dështuar të krijojë kushte themelore për personat me nevoja të veçanta. Kështu është thënë të enjten në seancën e Kuvendit të Kosovës, në të cilën është diskutuar për gjendjen e të drejtave të personave me nevoja të veçanta. Në Kosovë po shënohet Dita Ndërkombëtare e Personave me Nevoja të Veçanta - 3 Dhjetori. Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, gjatë debatit ka thënë se institucionet dhe shoqëria kanë bërë jashtëzakonisht pak për ta lehtësuar jetën e kësaj kategorie të shoqërisë dhe për këtë nevojitet rimëkëmbje gjithëpërfshirëse. "Duhet përfundimisht ta ndërrojmë perspektivën që ka shoqëria për personat me nevoja të veçanta,

le të mos e shohim si kufizim por, përkundrazi, potencial dhe mundësi që ata ofrojnë për t'i bërë gjërat ndryshe e shumë më mirë se sa i kemi bërë deri më sot. Personat me aftësi të kufizuara janë një aset i çmuar, janë potencial i jashtëzakonshëm, janë burim i zgjidhjeve dhe ideve për të cilat kemi aq shumë nevojë ne si shoqërorë", ka thënë Osmani. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka thënë se numri i personave me nevoja të veçanta në Kosovë konsiderohet nga 150 deri në 200 mijë. Ai ka theksuar se llojet e aftësive të kufizuara dallojnë nga njëra-tjetra, rrjedhimisht dallojnë edhe nevojat specifike të këtyre grupeve, për t'u përfshirë në jetën publike dhe shoqërore. "Gjendja e tanishme e personave të kufizuara nuk përmbush realizimin e të drejtave dhe lirive themelore në kushtet e barabarta me të tjerët.

Andaj si rrjedhojë të gjitha institucionet dhe shoqëria në përgjithësi janë përgjegjëse për realizimin e kësaj të drejte", ka theksuar Reçica. Nëpërmjet zbatimit të pagesave sociale dhe pensionale, sipas ministrit Reçica, ofrohen mbështetje financiare për mbi 30 mijë persona me aftësi të kufizuara, kurse vlera e mjeteve buxhetore që paguhet nga buxheti i Kosovës brenda një viti është mbi 50 milionë euro. Deputeti nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Fetah Rudi, i cili ka kërkuar debat parlamentar për këtë çështje, ka thënë se shteti ka dështuar të ofrojë kushte themelore për jetë personave me nevoja të veçanta. Rudi, që edhe vetë është person me nevoja të veçanta, ka thënë se në bazë të Kushtetutës, Republika e Kosovës ka për obligim t'i mbrojë dhe garantojë të drejtat dhe liritë e

njeriut. Pavarësisht kësaj, ai ka thënë se "personat me aftësi të kufizuara çdo ditë raportojnë për moszbatim të ligjeve, ngecje në shërbime të domosdoshme, shkallë të ulët të punësimit, shkallë të ulët të pjesëmarrjes në jetën politike dhe publike, vështirësi të qasjes fizike në institucione publike dhe paragjykimet". Kurse edhe më shqetësuese Rudi e sheh mungesën e kushteve elementare për të studiuar në universitete dhe shkolla shtetërore. Sipas Rudit, 8-15 për qind e popullsisë së përgjithshme në Kosovë vlerësohen se janë persona me aftësi të kufizuara. Ndërkaq deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Fitim Uka, ka thënë se megjithëse legjislacioni ua mundëson shkollimin dhe punësimin, qeveritë e dobëta e të pandjensja, përfshirë disa deputetë që ende janë edhe në

këtë legjislaturë e që flasin në këtë debat, kanë votuar kundër asistentëve nëpër shkolla për personat me aftësi të veçanta. "Duhet më shumë punë e më pak fjalë, më shumë mbikëqyrje e zbatim të legjislacionit edhe në punësim, pasi ligji thotë se për 50 të punësuar një duhet të jetë me nevoja të veçanta. Qeveria po vazhdon ta neglizhojë si sektorin privat si atë publik në këtë pikë", ka thënë Uka.

Ai ka theksuar se "asnjë nevojë e veçantë nuk mund ta definojë një person, secili person është unik dhe ata i definojnë vetëm puna dhe angazhimi i tyre. Por nevojat e veçanta mund ta bëjnë të vështirë jetën e një personi, prandaj duhet mbështetja e të gjithëve për ta mundësuar këtë rrugëtim të tyre, jo vetëm këtë ditë, por secilën ditë të tyre", është shprehur Uka.

Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Arbër Tolaj, ka thënë se Ligji për Personat me Aftësi të Kufizuara nuk zbatohet as nga institucionet private as nga ato publike. "Personat me nevoja të veçanta nuk kanë qasje të barabartë në arsim, punësim, shëndetësi, shërbime sociale si dhe në mbështetje juridike. Të drejtat e personave me nevoja të veçanta askush nuk mund t'i diskriminojë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike. Ligji për Personat me Aftësi të Kufizuara nuk zbatohet as nga institucionet private as nga ato publike. Edhe pse ky ligj i obligon ta punësojnë një person me nevoja të veçanta në çdo 50 të punësuar", ka thënë deputeti Tolaj. Ai ka shtuar se deri më sot asnjë institucion nuk është penalizuar apo dënuar për moszbatimin e këtij ligji, ndonëse thotë se nuk i përmbushin as për së afërmi kriteret të cilat kërkohen me ligj.

Situata politike në vend, Hoxhaj takon strukturat e PDK-së në Mitrovicë, Vushtrri dhe Fushë-Kosovë

MITROVICË, 3 DHJETOR (ER) - Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka takuar tri degët e kësaj partie, në Mitrovicë, Vushtrri dhe Fushë-Kosovë. Gjatë këtyre takimeve kryetari Hoxhaj i ka njoftuar këto degë me zhvillimet e fundit në lidhje

me Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike, për propozimet e PDK-së të cilat do të jenë pjesë e pakos dhe votimit që pritet të bëhet të premtën. Edhe në këto takime kryetari Hoxhaj e ka përsëritur formulën me të cilën është udhëhequr PDK-ja, opozitë ndaj qeverisë, por asnjëherë

ndaj shtetit dhe qytetarëve. Anëtarët e PDK-së në këto tri degë janë shprehur të kënaqur me këto vendime, duke i konsideruar të drejta e të cilat do ta shpëtojnë ekonominë e Kosovës dhe do t'u dalin në ndihmë të gjithë popullit në këto ditë të vështira pandemie.



Haziri: Viti 2021, me propozim të Handikosit, do të trajtohet vit i mundësive të barabarta

GJILAN, 3 DHJETOR (ER) - Me rastin e 3 dhjetorit, Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur sot në takim përfaqësues të organizatave, Fatmir Shurdhani nga Handikos dhe Bajram Spahiu nga Shoqata e të Verbërve, të cilët shoqëroheshin nga Avdil Ibishi e Naxhie Salihu.

Pasi ka uruar Ditën Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, kryetari Haziri ka thënë se kemi koordinim të mirë me organizatat në fjalë, duke shtuar se janë subvencionuar me të gjitha kapacitetet komunale. Ai tha se viti 2021, me propozim të Handikosit, do të trajtohet vit i mundësive të barabarta, duke shtuar se "Parku Baja" do të ndërtohet dhe emërtohet për

këtë komunitet, në mënyrë që të sensibilizohen institucionet për një politikë të drejtë. "Programi për qasje dhe mundësi të barabarta është në implementim e sipër në Gjilan. Unë e pranoj që shoqëria jonë ka bërë pak për këtë kategori, duke besuar se Zoti na ka falur të barabartë dhe mungesa e një gjymtyrë zëvendësohet natyrshëm për t'u bërë të barabartë në jetë", ka thënë Haziri, duke shtuar se kanë bërë përpjekje për t'iu krijuar qasje këtyre personave. "Besoj se ky është viti i fundit që mundësia e barabartë të zbatohet. Zbatimi i ligjit për punësim dhe trajtim për komunitetin është një prej detyrave që ne tash e tutje do të koordinohemi bashkë me këto organizata. Urime 3 dhjetori! Festofshim bashkë në kushte më të mira", ka shtuar Haziri.



Menaxheri i Handikosit, Fatmir Shurdhani, e ka falënderuar kryetarin Haziri për pritjen dhe mbështetjen e ofruar në vazhdimësi. "Diskutuam rreth gjendjes së personave me aftësi të kufizuara dhe për problemet që ballafaqohen. Gjatë bashkëbisedimit morëm

zotimin nga kryetari Haziri që viti 2021 të jetë vit i personave me aftësi të kufizuara, në kuadër të programit për mundësi të barabartë, që nënkupton se këta persona janë pjesë e shoqërisë dhe me të gjitha mundësitë nuk do të lihen anash këta persona, si në

arsim, punësim dhe jetë të përgjithshme", ka thënë Shurdhani. Në takim ka folur edhe kryetari i Shoqatës së të Verbërve në Gjilan, Bajram Spahiu, i cili ka falënderuar kryetarin Haziri për pritjen dhe mbështetjen e ofruar deri tani për këtë kategori.

Rregullohet ndriçimi publik në fshatin Kçiq i Madh

MITROVICË, 3 DHJETOR (ER) - Në kuadër të rregullimit të ndriçimit publik në fshatrat e Komunës së Mitrovicës ka përfunduar rregullimi i ndriçimit publik në fshatin Kçiq i Madh. Me rastin e funksionimit të ndriçimit publik në këtë fshat, drejtori për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, Naser Muja, ka thënë se, pos rregullimit dhe asfaltimit të rrugëve, tani kemi filluar fokusimin në një aspekt mjaft të rëndësishëm infrastrukturor, siç është ndriçimi i rrugëve në qytet dhe fshatra. Ndërsa drejtori Muja ka theksuar se projekti i rregullimit të ndriçimit publik në vendbanimet e Komunës së Mitrovicës është në proces e sipër dhe brenda këtyre muajve do të fillojë rregullimi i ndriçimit të rrugëve edhe në disa fshatra të komunës.



Drejtorja e Inspektorateve në Prizren shton inspektimet

PRIZREN, 3 DHJETOR (ER) - Drejtorja e Inspektorateve në Komunën e Prizrenit ka rritur numrin e inspektimeve si rrjedhojë e afimit të festave të fundvitit. Me këtë rast, në inspektimet e realizuara gjatë dy ditëve të fundit është bërë asgjësimi i artikujve të ndryshëm ushqimorë, sidomos të atyre me prejardhje shtazore, në vlerë

rreth 1 500.00 euro. Drejtorja e Inspektorateve u ka bërë thirrje të gjitha bizneseve që t'iu përmbahen rregullave dhe procedurave për kujdesin e artikujve me afat të skaduar. "Kujdesi ndaj shëndetit të qytetarëve mbetet prioritet kryesor dhe obligim i Drejtorisë së Inspektorateve", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.



Situata e sigurisë në Malishevë, stabile dhe e qetë

MALISHEVË, 3 DHJETOR (ER) - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Malishevë, nën drejtimin e nënkryetarit të komunës, Hajdin Berisha, të enjten ka mbajtur mbledhjen e rregullt, ku është vlerësuar situata e sigurisë së përgjithshme, ku u tha se situata është e qetë, stabile dhe pa tendencë të destabilizimit të kësaj situatë.

Komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiteni Azem Krasniqi, ka thënë se siguria e përgjithshme në Komunën e Malishevës është e mirë, stabile dhe pa tendencë të

destabilizimit të kësaj situatë. "Ka rënie të veprave penale, po ashtu edhe pse jemi në një situatë të rëndë pandemike, nuk ka probleme dhe krejt falë vetëdijes së lartë të qytetarëve të Komunës së Malishevës dhe mirëkuptimit të treguar gjatë pandemisë e sidomos gjatë karantinës", ka thënë Krasniqi. Sa i përket situatës pandemike në Komunën e Malishevës, nënkryetari Hajdin Berisha, në raportimin e tij, tha se situata me Covid-19 është nën kontroll të plotë, edhe pse në fillim të pandemisë kemi qenë komuna më e prekur por, falë qenësisë,

punës së pandërprerë, kjo situatë është qetësuar dhe tani jemi në mesin e komunave më të mira me gjendjen me Covid-19.

Po në këtë takim edhe drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, Hafir Rexha, ka raportuar për përgatitjet për sezonin e dimrit. "Janë kryer të gjitha procedurat dhe janë të gjitha përgatitjet për sezonin dimëror, po ashtu komuna është përgatitur edhe kujdesin në raport me rastet sociale gjatë këtij dimri, ku të gjitha familjet me gjendje jo të mirë ekonomike do të përkrahen", ka thënë Rexha.



OEAK-u dhe OEK-u mirëpresin përafrimin e qëndrimeve rreth Projektligjit për rimëkëmbje ekonomike

PRISHTINË, 3 DHJETOR (ER) - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) dhe Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) kanë mirëpritur përafrimin e qëndrimeve politike për kalimin e Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike si përgjigje në thirrjet e vazhdueshme të përfaqësuesve të sektorit privat. Këto oda kanë theksuar se plotësimi i projektligjit me rekomandime të mëtejme si

dhe shtimi i vlerës monetare të përkrahjes financiare ndihmon në adresimin më proporcional të kërkesave të bizneseve dhe dëmeve të shkaktuara nga pandemia Covid-19. "Prandaj, OEAK dhe OEK u bëjnë thirrje deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta mbështesin projektligjin në seancën e nesërme kur Projektligji pritet që të votohet në lexim të

dytë. Në të njëjtën kohë, të dyja odat ekonomike kërkojnë që sa më shpejt të jetë e mundur të kryhen përgatitjet e platformave përkatëse si dhe të përpilohen kriteret për shpërndarjen e përkrahjes financiare dhe zbatimin e masave të tjera të parapara me projektligj, në mbështetje të qytetarëve dhe ndërmarrjeve", thuhet në komunikatën e përbashkët të OEAK-ut dhe të OEK-ut.



Çmimet e importit shënuan ngritje



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Importit (IÇIMP) për tremujorin e tretë (TM3) 2020. Sipas ASK-së, indeksi i tërësishëm i çmimeve të importit në Kosovë u ngrit për 0.3 për qind në TM3 2020, krahasuar me TM2 2020. "Ngritje më të mëdha të çmimeve sipas sektorëve ishin te: lëkura dhe artikujt e saj (6.1 për qind); mjetet e transportit (3.5 për qind);

produktet minerale (1.9 për qind); instrumentet optike, fotografike, matëse, mjekësore dhe muzikore, si dhe mekanizmat e orës (1.9 për qind); këpucët (1.5 për qind); metalet bazë dhe artikujt e tyre (1.4 për qind); pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (1.2 për qind); artikujt ushqimorë të përgatitur, pijet dhe duhani (0.7 për qind); dhe artikujt e ndryshëm të prodhuar (0.7 për qind)", është thënë në raportin e ASK-së.

Sipas këtij raporti, ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e

çmimeve sipas sektorëve te: produktet bimore (-9.0 për qind); tekstili dhe artikujt e tij (-3.1 për qind); letrat dhe artikujt e saj (-2.4 për qind); vajrat ushqyese (-2.1 për qind); plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (-1.1 për qind); shtazët e gjalla dhe produktet e tyre (-0.6 për qind); produktet e industrive kimike (-0.4 për qind); dhe artikujt e gurit, llaçit, produktet e qeramikës dhe të qelqit (-0.2 për qind). "Ndërkaq, krahasuar TM3 2020 me TM3 2019, çmimet e importit pësuan rënie në një mesatare prej (-2.3

për qind). Rënie më të mëdha sipas sektorëve ishin te: produktet minerale (-17.7 për qind); tekstili dhe artikujt e tij (-14.1 për qind); metalet bazë dhe artikujt e tyre (-2.9 për qind); letra dhe artikujt e saj (-0.4 për qind); produktet e industrive kimike (-0.2 për qind); si dhe shtazët e gjalla dhe produktet e tyre (-0.1 për qind)", është thënë në raportin e ASK-së.

Në raport theksohet se rënia u neutralizua, kryesisht nga ngritja e çmimeve sipas sektorëve te: mjetet e transportit (5.3 për qind);

lëkura dhe artikujt e saj (5.0 për qind); këpucët (4.9 për qind); produktet bimore (4.0 për qind); pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (2.2 për qind); instrumentet optike, fotografike, matëse, mjekësore dhe muzikore, si dhe mekanizmat e orës (1.7 për qind); artikujt ushqimorë të përgatitur, pijet dhe duhani (1.5 për qind); plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (1.4 për qind); artikujt e gurit, llaçit, produktet e qeramikës dhe të qelqit (0.7 për qind); si dhe artikujt e ndryshëm të prodhuar (0.5 për qind).

OAK-u dhe EEN-i organizuan sesionin informues për zgjerim të tregut evropian

Prishtinë, 3 dhjetor (ER) - Oda e Afarizmit e Kosovës (OAK), në bashkëpunim me partnerin Enterprise Europe Network (EEN), ka organizuar sesionin informues me bizneset anëtarë, gjatë të cilit u informuan për mundësitë e zgjerimit të tregut nga ai vendor në atë evropianë dhe botërorë. Së fundi, Kosova është bërë pjesë e

rjetit EEN, pjesë e të cilit janë mbi 600 000 biznese dhe 60 shtete nga e gjithë bota ku, përveç vendeve të Evropës, përfshihen edhe Kanada, Brazili, ShBA dhe Zelanda e Re. Qëllim kryesor i EEN Kosova është krijimi i mundësive për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet kompanive vendore me ato ndërkombëtare, takime të cilat mund të realizohen të gjitha në

mënyrë virtuale, gjë e cila konsiderohet si lehtësi për bizneset, sidomos në këtë periudhë pandemie ku lëvizjet janë të kufizuara. Përmes kësaj platforme bizneset përfitojnë takime B2B, pjesëmarrje në ngjarje, panairë, konferenca dhe grante, pasi që për grante janë të ndara mbi tre miliardë euro.



ODA E AFARIZMIT TË KOSOVËS
CHAMBER OF DOING BUSINESS IN KOSOVO

A do të shpërthejë lufta e tretë botërore që LDK-ja humbi zgjedhjet në Podujevë



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Zhvillim normal në një gjendje jonormale: Për një kohë të gjatë kam jetuar në Podujevë/Besianë dhe tash është një gjendje krejtësisht tjetër. Kam jetuar në ish-rrugën "JNA", tash "Zahir Pajaziti", e banuar kryesisht me serbë jashtëzakonisht të ngarkuar kundër shqiptarëve e që këtë e demonstroi nga pozita e supremacionit shtypës. Nga hotel "Llapi" ku fillon rruga "Zahir Pajaziti" e deri te "Motel Besiana" ku përfundon kjo rrugë, të dyja anët ishin të banuara me shtëpi ku jetonin serbët, me përjashtim të familjes të Shaban Shalës (babait tim), të durulakëve që pastaj ia shitën pronën Sabit Hotit ku është kafja e famshme "Kafja e Sabitit", pak më poshtë ishte Haliti për të vazhduar me Nezir dhe Idriz Dyzin e pastaj ishin pronat dhe shtëpitë e blakçorëve, blakëve, raçëve dhe turrecëve. Kur filloi njëfarë lehtësimi i masave ndaj shqiptarëve me rënien e Rankoviqit, serbët, sidomos nga qendra i shitën pronat dhe u zhvendosën në Kurshumli, Prokupje dhe Nish ku e ndërjuan një lagje të quajtur Novo Sello, e banuar 100 për qind me serbë të Podujevës dhe të rrethinës. Gjeografinë politike dhe kombëtare e ndryshuan Baca Adem Demaçi, Shaban Shala, Hamit Berberi, Xheladin Rekalii, Ilaz Pireva, Hakif Sheholli, Ibrahim Durulaku, vëllezërit Qazim dhe Brahim Stublla Elhame Shala - Bogujevci që ishte bërthama e organizimit të rezistencës së viteve '60 dhe shumë atdhetarë të tjerë që e vazhduan rrugën e tyre, që nga demonstratat e vitit 1981 e deri në vitin 1999 kur falë luftës së lavdishme të UÇK-së, Kosova u çlirua. Nga viti 1989 e deri në vitin 1998 legalisht vepronin në Kosovë Lidhja Demokratike e Kosovës që e bëri një organizim paralel, si bërthamë e një rezistence paqësore në përpjekje që të


sigurohej liria e Kosovës, por pa marrë përgjegjësi për një organizim tjetër, përgatitjen e rezistencës së armatosur e që në ilegalitet e bënë grupet, kryesisht të ish të burgosurve politikë dhe Lëvizja Popullore e Kosovës. Kontribut të madh në këtë periudhë dhanë ShBH "Nëna Terezë" në planin e sigurimit të ndihmave humanitare, por dhe ndihmonte UÇK-në si dhe KMDLNJ-në në planin informativ për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë e që, gjithashtu, ishte aktive në mbështetje të UÇK-së, deri edhe në pjesëmarrje aktive në luftë. Ishte roli i pazëvendësueshëm i Bacës Adem Demaçi gjatë kësaj periudhe i cili nuk donte të rivalizonte LDK-në por, përkundrazi, kërkonte nga ne (ish të burgosurit politikë) ta përkrahim Ibrahim Rugovën duke e votuar në fillim të viteve '90, gjë që edhe e bëmë. Pas daljes nga burgu (vitet '90), LDK-ja në Podujevë nuk bashkëpunonte me të burgosurit politikë që ishin liruar duke i konsideruar si rivalë për marrje të primatit e në veçanti ishte një disponim i hapur kundër Bacës Adem Demaçi, sidomos kur e humbi besimin se me rezistencën e Rugovës Kosova do të lirohej e lëre më të çlirohej, prandaj u bë një fushatë e madhe ndaj Bacës anekënd Llapit duke e portretizuar si përçarës dhe kundërshtar të rezistencës paqësore, në ndërkohë që Baca përpigjej ta dinamizojë këtë rezistencë duke mos e përjashtuar as luftën e armatosur. Dega e LDK-së në Podujevë ku ishin edhe Xheladin Rekalii, Ilaz Pireva, Hakif Sheholli dhe të tjerë ndonëse ishin përkrahës të Bacës Adem Demaçi u gjendën midis dy zjarreve, Ibrahim Rugova në njërin anë të cilin e kishin kryetar partie dhe Baca Adem Demaçi që e llogarisnin udhëheqës shpirtëror dhe motivues për çdo rezistencë. Prandaj nuk arritën ta amortizonin fushatën kundër Bacës Adem Demaçi e cila burimin e kishte në zyrën e LDK-së në Prishtinë, kurse ekzekutohej në Podujevë dhe Llap. Pas përfundimit të luftës, deri në zgjedhjet e fundit lokale, LDK-ja ishte forcë politike

dominuese në Podujevë dhe Llap duke i fituar të gjitha zgjedhjet lokale. Figura qendrore që ua siguronte fitoren ishte Agim Veliu, kurse kryetar u zgjodhën, varësisht nga pozitat që mbante Agimi në nivelin qendror, i ndjeri Agim Kika dhe Ilaz Pireva.

Zgjedhjet e fundit lokale: Favoritë për fitues të zgjedhjeve të fundit lokale në Podujevë për mandatin e mbetur 8 muajsh ishin Nexhmi Rudari i LDK-së dhe Shpejtim Bulliqi i LV-së, kurse Naim Fetahu i PDK-së ishte eskortë që do të vendoste për fituesin e zgjedhjeve në rast balotazhi. Naim Fetahu ishte autsajder absolut, pa asnjë gjasë për fitore dhe për mua ishte e habitshme pse pranoi këtë garë kur nuk kishte kurrfarë gjasash. Duhet të thuhet publikisht se foshnjoren e njohurive politike Shpejtim Bulliqi dhe Nexhmi Rudari e kryen në LDK dhe kryeeducatori politik atëherë dhe deri kur i ndanë rrugët ishte Agim Veliu. Agim Veliu e krijoi politikisht edhe Shpejtim Bulliqin sikur edhe Nexhmi Rudarin. Kjo është më se e vërtetë! Më herët LV-ja garoi me dr. Ali Lahun dhe Ajet Poterën, por u mundën nga LDK-ja dhe Agim Veliu. Tash Albin Kurti e fitoi Podujevën me ish-armën e LDK-së, Shpejtim Bulliqin, por tani me mbushje të LV-së. Nuk jam marrë aspak me këto zgjedhje për faktin se fituesi ka mandat të mbetur në kohëzgjatje prej tetë muajve dhe këtë fitore më shumë e konsideroj si efekt psikologjik sesa mundësi që për një kohë të shkurtër të bëhen ndryshime të premtuara gjatë fushatës së LV-së. Kam menduar se do të shkohet në balotazh, por doli më mirë që nuk u shkua për faktin se na kanë kursyer nga edhe një votim ku unë as që kam qenë votues. Llapjanët i njohin mirë edhe Shpejtim Bulliqin sikur edhe Nexhmi Rudarin, por duhet të pranohet fakti se këtu gladiatorë politikë kanë qenë Albin Kurti dhe Agim Veliu. Albini doli fitues i pakontestueshëm dhe duhet të urohet për fitore, fillimisht nga Agim Veliu e pastaj edhe nga ata që nuk mendojnë si Albini sepse as nuk janë armiq e as nuk duhet të jenë armiq. Thjesht, janë rivalë politikë! Është e pamohueshme se

zgjedhjet në Podujevë i ka fituar Albin Kurti, kurse i ka humbur Agim Veliu. Agim Veliu ka merita të mëdha për të gjitha fitoret e LDK-së në Podujevë, mirëpo çdo fillim e ka edhe një mbarim. Sa më parë ta kenë kuptuar këtë Agim Veliu dhe LDK-ja, aq më mirë do të jetë për ta për faktin se zgjedhjet lokale janë në prag të derës, në tetor të vitit 2021. Madje, në rrethana të reja, shumë më vështirë do të jetë për LV-në dhe Albin Kurtin se për LDK-në dhe Agim Velin. Tetë (8 muaj) janë shumë pak për matje të performancës së Shpejtim Bulliqit dhe LV-së, aq më parë që e kanë një opozitë të fuqishme që bashkërisht ka afërsisht 48.5 për qind të votave. Se si do të reflektojë LDK-ja, është çështje e partisë, kryetarit të saj dhe Agim Velit, si kryetar dege, mirëpo këtë humbje nuk do ta ngrehja në nivelin e tragjedisë së Shekspirit e lëre më si pretext për fillimin e Luftës së Tretë Botërore. Është një zhvillim demokratik, sigurisht i nevojshëm dhe i domosdoshëm pasi kështu e kanë vlerësuar dhe votuar votuesit në Podujevë. Do të ishte shumë mirë dhe e shëndetshme për demokracinë dhe qytetarët llapjanë që tranzicioni i pushtetit të jetë demokratik dhe që opozita, pa hatërbetje për humbjen e zgjedhjeve të bëhet bashkëpunuese në realizimin e projekteve të filluara sikur që edhe fituesi, Shpejtim Bulliqi i LV-së duhet të jetë shumë i kujdesshëm me opozitën, duke e respektuar dhe trajtuar në mënyrën më demokratike të mundshme. Tash Shpejtim Bulliqi nuk është vetëm kryetar i votuesve që e kanë votuar, por është kryetar i të gjithë qytetarëve llapjanë. Zgjedhjet e tetorit të vitit 2021 do të jenë ose rikonfirmim i fitores së merituar të LV-së, nëse iu përmbahet premtimeve të fushatës, në të kundërtën mund të jetë rikthim i LDK-së! Nuk jam as votues i LDK-së e as votues i LV-së. Në jetën time vetëm një herë kam votuar, me kërkesën e Bacës Adem Demaçi, në fillim të viteve '90, në emër të unitetit kombëtar për Ibrahim Rugovën, në nivelin qendror dhe për Rifat Blakun, në nivelin komunal. Nuk kam përvojë të mirë nga e

kaluara me LDK-në sepse, pasi jemi liruar nga burgu në vitet '90 jemi sulmuar dhe etiketuar si "të kuq" vetëm pse nuk jemi pajtuar me, ta quaj kushtimisht rezistencën e atëhershme. LV-në e kam përkrahur shumë në kohën kur shumica e kanë sulmuar dhe kur e kanë pasur më së ngushti, por se rrugët i kemi ndarë paqësisht ndonëse apartaçikët e saj më kanë sulmuar, pa asnjë bazë. LV-ja që e pata përkrahur, pa asnjë rezervë në atë kohë, së bashku me Bacën Adem, Qalin dhe shumë të tjerë thuaja nuk ka asgjë të përbashkët me LV-në e sotme, përveç emrit. Mund ta kem edhe gabim, nuk jam i pagabueshëm, mirëpo aktivistët e orëve të para të LV-së, me një bagazh dhe kontribut të pakontestueshëm kombëtar dhe politik, kam përshtypjen që nuk janë zëri që dëgjohen shumë e që marrin vendime. Janë disi në margjinë dhe në skenë janë snajperistët e



rrjeteve sociale që pushkatojnë pa asnjë kriter dhe pa asnjë moral, kundërshtarët e projektuar si të tillë ndonëse kapitali i tyre kombëtar dhe politik është fare modest! Krahasuar me subjektet e tjera politike, LV-ja i ka dy përparësi përcaktuese që e bëjnë dallimin dhe i sigurojnë fitore, karizma dhe oratoria mbresëlënëse krahasuar me liderët tjerë, e Albin Kurtit sikur edhe organizimi në terren dhe vendosmëria e aktivistëve të punojnë në të gjitha kushtet dhe në të gjitha rrethanat! Janë sakrifikuës, pa asnjë dyshim!

Çka në dhe për të ardhmen: LV-ja i fitoi zgjedhjet e fundit parlamentare dhe bëri koalicion me LDK-në si pjesë e një marrëveshjeje parazgjedhore pas së cilës Albin Kurti u zgjodh kryeministër, kurse Vjosa Osmani, kryetare e Kuvendit. Ishin pritje të mëdha, por se shpejt përfundoi ky koalicion i quajtur "Koalicion i Shpresës". Kam përshtypjen se shkarkimi i Agim Veliut ka qenë i provokuar pikërisht për ta rrëzuar qeverinë dhe se Albin Kurti, si kryeministër dhe si udhëheqës i dialogut, pasi është informuar për përmbajtjen e bisedimeve ka hezituuar të shkojë në bisedime. Mirëpo, mënyra, koha dhe arsyetimi për

rrëzim të qeverisë Kurti ka qenë krejtësisht jo e drejtë dhe në kundërshtim me moralin. Albin Kurti e quan Avdullah Hotin dhe Qeverinë e Kosovës si ilegjitime që nuk është e vërtetë shkaku se qeveria Hoti e ka kaluar votimin në Kuvend. Kontestimi i votës së Etem Arifit është kryesisht nga aspekti moral, kurse në aspektin ligjor nuk ka asnjë mundësi të kontestohet për faktin se ai ka pasur mandat të deputetit për të votuar. Infrastruktura ligjore e ngatërruar e ka shkaktuar këtë problem. Lëshimi i parë, edhe moral, edhe ligjor është i deputetit Etem Arifi i cili, pasi e ka pranuar aktgjykimin e formës së prerë nuk i ka informuar institucionet përgjegjëse. Në një shtet normal, për këtë fshehje e që mund të konsiderohet si falsifikim i gjendjes së vërtetë, ish-deputeti Arifi do të duhej të përgjigjej para ligjit. Lëshimi tjetër substancial është i gjykatës kompetente që, pas aktgjyimit të formës së prerë, nuk i ka informuar menjëherë Kryesinë e Kuvendit, kryetaren dhe sekretarin e Kuvendit si dhe Komisionin Parlamentar për Legjislacion në mënyrë që t'i ndërmarrin veprimet e duhura për zëvendësimin e deputetit Arifi, me deputetin e radhës. Në

rastin konkret, LV-ja ka të drejtë morale, të tjerët, në mungesë të informatës për këtë rast, kanë të drejtë ligjore dhe nuk kanë fare përgjegjësi.

Por edhe pa rastin Arifi situata është e rëndë për faktin se qeveria Hoti nuk po ka numra për draftim të ligjeve e as Kuvendi për votim të ligjeve. Nga kjo situatë mund të dilet me zgjedhje të reja të cilat nuk e besoj se do ta krijojnë një situatë më të mirë edhe nëse LV-ja i merr 50 për qind të votave. Deri tani LV-ja ka dëshmuar probleme të theksuara në qeverisje, si në planin qendror, po ashtu dhe në atë lokal. Nëse ka mbledhur mend nga pësimet, atëherë mund të jetë më mirë. LV-ja për fillim duhet krejtësisht ta eliminojë hakmarrjen sepse, siç thotë Konfuçi: "Nëse shkoni të hakmerreni, atëherë duhet të hapni dy varre...". Ashtu ndodhi në blic qeverisjen e LV-së. Nëse LV-ja planifikon koalicion me AAK-në atëherë duhet ta plotësojnë kushtin e Ramushit. Presidentin për Ramushin! AKR-ja asgjë nuk i ndihmon LV-së ndonëse Pacolli fort po e mbështet LV-në dhe Albinin. Duket se bisedimet me Serbinë është: "Kafshatë që nuk kapërdihet..." për LV-në dhe Albinin. Nëse kundërshton

bisedimet, atëherë ia shkurtojnë mandatin, kurse nëse i pranon kushtet, njëjtësohet me të tjerët! Në momentin kur të qetësohet pandemia, në sipërfaqe do të dalin shumë probleme sociale dhe ekonomike e që do të përdoren edhe politikisht dhe, mos qofsha në lëkurën e kryeministrit në atë kohë! Mundësia tjetër është koalicioni i gjerë i të gjitha subjekteve politike duke e lënë opozitën të vetme LV-në. Ky koalicion në zgjedhjet lokale do të pësonte shumë ani pse e ka pushtetin qendror. Në fund të fundit, si çdoherë deri më tani, asnjë koalicion nuk bëhet pa mamitë ndërkombëtare! E mira e së mirës është që të gjitha subjektet politike të bëhen bashkë, të arrijnë një konsensus nacional, politik dhe shtetëror në mënyrë që pasojat e bisedime të jenë sa më të lehta dhe sa më të menaxhueshme! Asociacioni i Serbisë në Kosovë do të formohet sipas Marrëveshjes së Brukselit, por ata tereqtë e BE-së po kërkojnë ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës. Ne po e kundërshtojmë verbalisht sikur që gjithmonë kemi kundërshtuar por, në fund gjithmonë është materializuar kërkesa e ndërkombëtarëve me

një ambalazhim dhe premtim mashtrues të cilin politikanët e vendit e kanë përdorur si arsyetim.

Kujtojeni liberalizimin e vizave! Nuk mbeti kush pa na rrejtur dhe mashtruar. Në aspektin psikologjik dhe kur jeni inferior dhe i pafuqishëm, më shumë i besoni një rrene të bukur se një të vërtetë!

LV-ja po insiston në zgjedhje sepse është e sigurt se i fiton. Lista Serbe po insiston në zgjedhje duke iu bërë presion institucioneve të Kosovës në kohën kur duhet të votohet buxheti i Kosovës. AAK-ja zgjedhjet i ka si vjegëz dhe kusht për postin e presidentit, nëse bëhet me Hotin, mirë, nëse jo, atëherë shkohet në zgjedhje, pas një marrëveshjeje me LV-në dhe Albin Kurtin. LDK-ja dhe PDK-ja, ndonëse po deklarohen se janë të gatshme për zgjedhje, nuk e besoj se e kanë seriozisht dhe se janë të sinqertë! Nuk i duan zgjedhjet në këtë kohë!

Dhe problemi kryesor në Kosovë është se rezultatit e zgjedhjeve të jashtëzakonshme, nëse ato do të organizohen, nuk do ta certifikojnë KQZ-ja dhe Valdete Daka, por Gjykata Speciale dhe Jack Smith. Ata edhe do të jenë votuesit kryesorë!



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Prishtina kërkon fitore në derbin ndaj Feronikelit



Mesfushori Endrit Krasniqi ka thënë se Prishtina është e gatshme për t'i marrë tri pikët e plota në ndeshjen kundër Feronikelit e cila zhvillohet sot në stadiumin "Fadil Vokrri". "Shpresoj se me lojë të mirë të korrin fitore në përballjen me Feronikelin, i cili ka ekip të mirë, por nuk e ka pasur formën optimale që nga fillimi i kampionatit", ka thënë Krasniqi

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Java e gjashtëmbëdhjetë në Superligën e Kosovës në futboll fillon sot (e premte) me ndeshjen Prishtina - Feronikeli e cila zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" nga ora 13:00. Kryeqytetasit kanë mbetur 11 pikë pas skuadrës lidere, Ballkanit, dhe në ndeshjen e sotme hyjnë për fitore në mënyrë që të mos shtohet dallimi i pikëve me skuadrat e para, derisa në anën tjetër "Nikli" po kalon nëpër një formë të mirë dhe do të përpiqet të marrë pikë në Prishtinë. Mesfushori Endrit Krasniqi ka thënë se ndeshja është e vështirë, por Prishtina është e gatshme për të korrur fitore. "Të gjitha ndeshjet e mbetura të stinorit vjeshtor janë të rëndësishme dhe gjithsecila më e vështirë se tjetra dhe që të gjitha pretenduese për kreun e tabelës. Shpresoj se me lojë të mirë të

korrim fitore në përballjen me Feronikelin, i cili ka ekip të mirë, por nuk e ka pasur formën optimale që nga fillimi i kampionatit. Është ekip i rrezikshëm, por ne do të përpiqemi t'i kryejmë detyrat tona të cilat i kemi për ta arritur objektivin që kemi", ka thënë Krasniqi për faqen zyrtare të klubit prishtinas. "Bardhekaltrit" në ndeshjen e fundit kanë shënuar fitore ndaj Besës (0-2) dhe aktualisht e mbajnë pozitën e tretë me 24 pikë, kurse me rezultat të njëjtë fitore ka shënuar edhe Feronikeli ndaj Trepçës '89. Ish-kampionët e Kosovës renditen në vendin e pestë me 19 pikë.

Drita merr tri pikë ndaj Llapit

Kampionia në fuqi e Superligës, Drita, ka shënuar fitore të vlefshme në përballje me Llapin (1-0), në ndeshjen e mbetur të javës së parë.

Në minutën e 17 Ardian Limani shënoi për epërsinë e parë të vendësve. Pjesa e parë u mbyll me rezultat 1-0, kurse në pjesën e dytë rastet nuk munguan nga të dyja skuadrat, por rezultati nuk ndryshoi dhe gjilanasit arkëtuan pikët e plota. Pas kësaj fitore, Drita është e dyta në renditjen tabelore me 30 pikë të grumbulluara, kurse Llapi vazhdon të mbetet në pozitën e parafundit me 11 pikë.

SUPERLIGA - Java e 16-të

**Të premten takohen:
13:00 Prishtina - Feronikeli**

**Të shtunën takohen:
13:00 Trepça '89 - Gjilani
13:00 Arbëria - Drenica**

**Të dielën takohen:
12:00 Llapi - Besa**

SHKURT

Bremeni nuk e shet Rashicën në janar

Werder Bremeni nuk është në gjendje ta shesë sulmuesin anësor nga Kosova, Milot Rashica, në afatin kalimtar të janarit. Sulmuesi i Kosovës ishte afër të nënshkruante në verë me klubin anglez Aston Villa dhe atë gjerman Bayer Leverkusen. Megjithatë, një gjë e tillë nuk u materializua dhe tanimë gjithçka ka ndryshuar në bindjen e drejtuesve të klubit gjerman. Drejtori sportiv i klubit, Frank Baumann, ka thënë se askush nga ekipi, përfshirë edhe Rashicën, nuk do të largohet në janar. "Unë do ta përjashtoj largimin e të gjithë lojtarëve tanë në dimër", ka thënë Baumann për gazetën "Bild".

Mehmedi mungon në pjesën e mbetur të vitit

Wolfsburgu ka konfirmuar përmes "Facebook"-ut se Admir Mehmedi ka pësuar një lëndim që do ta lë jashtë fushës për këtë vit. Klubi gjerman ka konfirmuar se ai ka lënduar tendinën e Akilit, problem të cilin e ka pasur edhe më parë. "Jashtë për pjesën e mbetur të vitit - Admir Mehmedi me problemin e tendinës së Akilit. Të dëshirojmë rikuperim të shpejtë, Admir", thuhet në njoftimin e Wolfsburgut. Sulmuesi 29-vjeçari ka luajtur në 13 ndeshje këtë edicion dhe ka realizuar 2 gola e ka dy asistime.

Berisha në garë për lojtarin më të mirë të javës në Ligën e Kampionëve

Mërgim Berisha po paraqitet mjaft mirë me skuadrën e Red Bull Salzburg. Berisha shkëlqeu me lojën e tij kundër Lokomotives së Moskës, duke realizuar dy gola në fitoren 1-3. Sulmuesi me prejardhje nga Kosova, me këtë rast është kandidat për t'u shpallur lojtar i javës në garën më prestigjioze të futbollit evropian për klube, Ligën e Kampionëve. Futbollisti i Salzburg, është në konkurrencë me Olivier Giroud, İrfan Can Kahveci dhe Romelu Lukaku.

Neymari: Vitin tjetër do të luajmë së bashku me Messin

Neymari ishte autor i dy golave dhe një loje shumë të bukur në ndeshjen që PSG-ja e fitoi kundër Manchester Unitedit. Pas ndeshjes braziliani foli për ESPN dhe preku edhe një herë bashkimin me Leo Messin. Ai u shpreh se dëshira më e madhe e tij në këtë moment është të luajë sërish me "Pleshtin" dhe ka besim se mund ta bëjë këtë që në sezonin e ardhshëm. "Dëshira ime më e madhe është të luaj sërish me Messin. Dua të luaj me të. E lë të luajë në pozicionin tim nëse dëshiron. Vitin tjetër do të luajmë së bashku, me siguri", ka thënë Neymar. Mbetet për t'u parë nëse Neymari e ka fjalën për kalimin e Messit te PSG-ja, apo rikthimin e tij te Barcelona. Kontrata e argentinasit me Barçën përfundon verën e ardhshme dhe nga janari Messi mund ta zgjedhë klubin e ri. Chelsea, PSG-ja dhe Manchester City janë klube që përballojnë financiarisht Leon.

Petronas paralajmëron Rossin: Një legjendë, por këtu rregullat i bëjmë ne

URBINO, 3 DHJETOR - Valentino Rossi do të garojë me Yamaha Petronas sezonin e ardhshëm të MotoGP, motorin satelit të Yamahas, me të cilën ai ka garuar vitet e fundit. Duke folur për këtë transferim, Wilco Zeelenberg, drejtori

sportiv i Petronas, bën të qartë strategjinë që ky motor do ta përdorë vitin tjetër. "Valentino Rossi është i rëndësishëm në sportin tonë, por me të kemi qenë të qartë që në fillim: Do të jemi ne ata që do të vendosim për strategjinë", ka

thënë Zeelenberg, duke shtuar: "Për ne është një nder që ai do të garojë me motorin tonë dhe do të ishte çmenduri të mos e merrnin dhe ta refuzonim ofertën e Yamahas. Ne duam që të dy pilotët tanë, Rossi dhe Franco Morbidelli,

ta japin dhe marrin më të mirën nga motori ynë. Këtë vit fituam 6 gara dhe kjo nuk është pak, ndaj presim një sezon të mirë me këta dy pilotë. Gjithsesi, ata duhet t'i respektojnë rregullat tona, sidomos Rossi".



Pele, mesazh prekës për Maradonën: Të dua, Diego!

Sao Paulo, 3 dhjetor - "Një ditë do të luajmë së bashku atje lart në parajsë", ishin fjalët e Peles kur mori vesh se kundërshtari i tij më i madh në garën e më të mirë në histori, Maradona, ndërroi jetë. Kjo ndodhi një javë më parë në shtëpinë e Diego në Tigres pas atij sulmi. Pele është ende shumë i lënduar nga ikja e argjentinastit dhe, së fundmi, e ka treguar pikëllimin e tij në një postim në "Facebook". Pele i thotë për herë të parë Maradonës se e do. "Sot kanë kaluar shtatë ditë qëkur u largove. Shumë njerëz donin të na krahasonin gjithë jetën e tyre. Ti ishe një gjeni që magjepsi botën. Një magjistër me topin në këmbë. Një legjendë e vërtetë. Por, mbi të gjitha, për mua ti do të jesh gjithmonë një mik i shkëlqyer me një zemër të madhe. Sot unë e di se bota do të ishte shumë më mirë nëse ne të do krahasoheshim më pak njëri-tjetrit dhe të fillonim të na admironim më shumë. Kështu që, dua të them ti je i pakrahasueshëm", ka shkruar Pele. "Trajektorja jote u shënuar nga



ndershmëria. Dhe në mënyrën tënde unike dhe të veçantë, na mësove se duhet të duam dhe të themi 'të dua' shumë më shpesh. Largimi i shpejtë i yti nuk më la të ta them, kështu që unë thjesht do të shkruaj: Të dua, Diego! Shoku im i madh, shumë faleminderit

për tërë udhëtimin tonë! Një ditë në parajsë do të luajmë së bashku në të njëjtën skuadër. Dhe do të jetë hera e parë që ngre grushtin tim lart si triumf në fushë pa festuar një gol. Do të jetë sepse, më në fund, mund të të përqafoj përsëri", ka shkruar Pele në "Facebook".

Finalja e madhe evropiane në 'Arena Kombëtare'

TIRANË, 3 DHJETOR - Federata Shqiptare e Futbollit ka njoftuar se "Air Albania Stadium" ("Arena Kombëtare") mirëpret finalen e "Conference League" në vitin 2022. Komiteti Ekzekutiv i UEFA-s është mbledhur sot përmes video-konferencës dhe mori një vendim historik për Shqipërinë.

Finalja e "UEFA Conference League", turneut më të ri evropian për klube, që do të nisë sezonin e ardhshëm, do të zhvillohet në stadiumin kombëtar "Air Albania" në vitin 2022. Kjo është hera e parë në historinë e sportit shqiptar që vendi mirëpret një finale evropiane të këtyre përmasave. Shqipëria ishte një nga kandidatet kryesore për zhvillimin e kësaj finaleje, por arriti të lërë pas Irlandën e Veriut dhe Finlandën. Në këtë mbledhje historike mori pjesë edhe presidenti i FShF-së,



Armand Duka, njëherësh edhe anëtar i Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s, i cili ka pasur një rol kyç, duke lobuar vazhdimisht për këtë vendim. Gjatë mbledhjes presidenti Duka falënderoi të gjithë anëtarët e Komitetit Ekzekutiv për

mbështetjen që po i japin Shqipërisë, në veçanti futbollit shqiptar. Një event i këtyre përmasave është një mundësi fantastike promovimi për Shqipërinë, që do të jetë në qendër të vëmendjes për disa ditë me radhë.

SHKURT

Sevilla interesohet për Shaqirin

Skuadra spanjolle, Sevilla, ka hyrë në garë për t'i siguruar shërbimet e futbollistit shqiptar, Xherdan Shaqirit. Sipas asaj që raportohet në mediumet spanjolle, Sevilla tashmë ka kontaktuar drejtuesit e Liverpoolit për të arritur marrëveshje për transferimin e Shaqirit në afatin kalimtar të janarit. 29-vjeçari nga Zhegra e Gjilanit këtë sezon ka pasur probleme me lëndime dhe ka luajtur vetëm në pesë paraqitje për "Të Kuqtë" në të gjitha garat, duke shënuar një gol dhe duke ndihmuar skuadrën me një asistim. Kontrata e tij me Liverpoolin skadon në vitin 2023, derisa kartoni i tij vlerësohet rreth 15 milionë euro. Në garë për lojtarin janë edhe Roma e Galatasaray të cilët synojnë shërbimet e Shaqirit.

LeBroni vazhdon kontratën me LA Lakers

Një nga yjet më të mëdhenj në NBA, LeBron James, ka zgjatur kontratën me Los Angeles Lakersit edhe për dy vjet. James, i cili do ta festojë ditëlindjen e 36-të në fund të muajit, do të qëndrojë te Lakersi deri në fund të sezonit 2022/2023, i cili do të jetë edhe sezoni i 20 i tij në NBA. Lakersat sezonin e fundit fituan titullin e NBA-së dhe Jamesi ishte një nga meritoret për këtë sukses. Në të kaluarën Jamesi kishte fituar dy tituj te Miami dhe një te Clevelendi. Lakersi edhe në sezonin e ri do të jetë favorit për titull, sidomos pas përforcimeve me Montrezl Harrell, Dennis Schroder dhe Marc Gasol.

Dy yjet e Monchengladbachut në 'radar' të Bayernit

Kampionia e Evropës dhe Gjermanisë, Bayern Munchen, po planifikon transferimin e dy futbollistëve të Borussia Monchengladbachut, Denis Zakaria dhe Florian Neuhaus, raporton "Blid". Për transferimin e kësaj dyshe skuadra "bavareze" duhet të ndajë plot 80 milionë euro.

Juve e dëshiron Umtitin

Mbrojtësi i Barcelonës, Samuel Umtiti, është në radarin e Juventusit, raporton "Mundo Deportivo". "Bianconeri" është duke e shikuar francezin 27-vjeçar si zëvendësues i mundshëm i Giorgio Chiellinit, që është duke shkuar drejt fundit të karrierës së tij. E përveç tij, Juventusit në listën e transferimeve ka edhe Sokratis Papastathopoulosin, Nikola Milenkoviçin dhe David Alaban.

Kloppi, pasardhës i Lowit te Gjermania

Humbja e turpshme 6-0 përballë Spanjës ka lënë një gjurmë të thellë në opinionin sportiv gjerman. Ish-lojtarë të famshëm të katër herë kampionëve të botës, figura me shumë influencë, kërkuar shkarkimin e Joachim Low, por në mënyrë befasuese drejtuesit e Federatës Gjermane, edhe pse të përçarë, në fund vendosën ta konfirmojnë, të paktën deri në 2022. Low ka shansin e fundit për ta ndreqë atë humbje, e vetmja mënyrë për ta konfirmuar sërish është fitimi i një tjetër trofeu madhor, "Euro2021" apo Botërori "Katar 2022", gjithnjë nëse do të arrijë deri në Botëror. Sipas të përditshmes gjermane "Bild", Federata e ka konfirmuar Lowin deri në vitin 2022, më pas për të nisur një cikël të ri me Jurgen Kloppin në stol. Ky është objektivi kryesor i drejtuesve, por më parë duhen ta bindin Kloppin i cili ka një kontratë me Liverpoolin deri në vitin 2024.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova - Ministry of Internal Affairs

KONKURS

Në bazë të Nenit 14 të LIGJI Nr. 05/L - 085 për Energjinë Elektrike, Ministria e Punëve të Brendshme shpall konkurs për këtë vend pune:

Titulli i vendit të punës:

Drejtor të Bordit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit-
Për përfaqësues nga radhët e komuniteteve jo shumicë

KUALIFIKIMI DHE PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE

Një kandidat për t'u zgjedhur drejtor i Bordit në Ndërmarrje Publike Qendrore duhet të ketë kualifikime dhe përvojë pune sipas nenit 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, dhe Neni 9 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, si vijon:

- Të ketë së paku pesë (5) vjet përvojë pune në nivel të lartë të menaxhimit në fushat e poshtëshënuara:
 - në administrim të biznesit;
 - financa të korporatave;
 - financa publike ;
 - menaxhim thesari;
 - banka;
 - biznes konsultimesh;
 - industri ose
 - të ketë qenë së paku për 5 vjet kontabilist i certifikuar, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i ndonjë profesioni tjetër që ndërlidhet me veprimtarinë afariste të Ndërmarrjeve Publike Qendrore.

Në rast të numrit të lartë të aplikacioneve, kriteret e mëposhtme të dëshirueshme do të përdoren për të vlerësuar aplikacionet, me ç' rast kandidatët e pasuksesshëm do të eliminohen në fazën e shqyrtimit të CV-ve në procesin e rekrutimit:

Diplomë Bachelor

Diplomë Master,

Kualifikimi profesional pas -diplomimit,

Anëtarë i një shoqate profesionistësh të pranuar në nivel kombëtar

Përvoja e punës në institucione/projekte ndërkombëtare,

Përvoja e punës në pozitë drejtori ekzekutiv,

Aftësia për të folur dhe të shkruar rrjedhshëm një gjuhë të huaj.

KUSHTET

Një person nuk ka të drejtë të shërbejë si drejtor në Bordin e Ndërmarrjes Publike Qendrore, nëse:

- Ka qenë i dënua dhe është nën hetime nga një gjykatë kompetente;
- Ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër i ankesave;
- Nuk ka bërë përgjeshtrime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim;
- Ka qenë në post menaxhues të ndonjë kompanie që ka falimentuar gjatë dhjetë (10) vjetëve të fundit.
- Nuk punon në ndonjë institucion ku bëhen politikat zhvillimore për Ndërmarrjet Publike ku kandidati aplikon.

Kandidati nuk mund të zgjidhet drejtor në Bordin e Ndërmarrjes Publike Qendrore, nëse:

- Aktualisht është zyrtar, menaxher i Ndërmarrjes Publike përkatëse, (në kuptim të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrje Publike), ose cilëso nga filialet e saj;
- Ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i Ndërmarrjes Publike përkatëse ose cilëso nga filialet e saj brenda pesë (5) vjetëve të kaluara;
- Aktualisht ka, ose gjatë tre vjetëve të kaluara ka pasur, çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç si konsumator individual i shërbimeve të Ndërmarrjeve Publike) me Ndërmarrjen Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
- Është aksionar, drejtor ose zyrtar në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i cili ka marrëdhënie materiale afariste me Ndërmarrjen Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- Pranon, ose ka pranuar brenda tre (3) vjetëve të kaluara, kompensim shtesë nga Ndërmarrja Publike përkatëse ose cilado nga filialet e saj (përveç honorarit të Drejtorit ose kompensimit stimulues të përcaktuar në nenin 20.1 të Ligjit për Ndërmarrje Publike), ose është anëtar në skemën pensionale të Ndërmarrjes Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- Përfaqëson një aksionar i cili posedon mbi dhjetë për qind (10%) të aksioneve votuese në Ndërmarrjen Publike përkatëse;
- Ka shërbyer në Bordin e Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike përkatëse më shumë se nëntë (9) vjet nga data e zgjedhjes së parë të tij/saj;
- Është i afërm i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e "Interesit Financiar" në nenin 2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike) i cilitdo person që i takon cilëso nga kategoritë e sipërpërmendura.
- Është zyrtar, drejtor ose aksionar, ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare që konkurron me Ndërmarrjen, ose është menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy për qind (2%) të drejtave të votimit), ose ka një interes të konsiderueshëm financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare që konkurrojnë me Ndërmarrjen;
- Është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 mujore para datës së aplikimit ka qenë zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- Ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktojnë që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij financiare ndaj Aksionarëve dhe Ndërmarrjeve Publike.

AFTESITE PERSONALE TE KËRKUARA

- Udhëheqje
- Punë ekipore
- Përdorimi i internetit

- Të menduarit strategjik
- I/e orientuar ndaj rezultateve
- Vendim-marrja
- Aftësi ndikuese
- Koherencë të qartë, komunikim konciz
- Integritet
- Vetëdije
- Të menduarit kreativ

KOHËZGJATJA E MANDATIT:

Mandati i secilit anëtar të Bordit është katër (4) vjeçar, me mundësi emërimi edhe për një mandat tjetër në vazhdim. Mandati i secilit anëtar të Bordit fillon nga data e emërimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët për drejtorë në Bordin e Ndërmarrjes Publike duhet të dorëzojnë këto dokumente (Dështimi për ta bërë këtë do të rezultojë në refuzimin e aplikacionit):

- CV-në e cila ofron shembuj të arritjeve në punë
- Letër motivimin
- Deklaratën nën betim (formular, i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit)
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës)
- Certifikatën (dëshminë) që dëshmon se nuk është nën hetime
- Shtetas i Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit).

Aplikuesi duhet të plotësojë personalisht deklaratën nën betim me rastin e aplikimit, në të cilën deklaron se ai/a jo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisht dhe të përshtatshmërisë profesionale. Çdo përgjeshtrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë në diskualifikimin e menjëhershëm.

Dokumentacioni duhet të jetë në pliko (zarf) të mbyllur ku shkruhet emri dhe mbiemri si dhe emri i Ndërmarrjes Publike në të cilën konkurron kandidati dhe të dorëzohet në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Zyra e Personelit, zyra nr. 320, kati III, ndërtesa e Pallatit të Shtypit, Prishtinë, ose nëpërmjet adresës elektronike në linkun: <http://map.rks-gov.net>

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Origjinalet kërkohen gjatë intervistës.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes telefonit 038/ 200 30 185.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

Kompensimi i anëtarëve të Bordit, përcaktohet nga Kuvendi deri në nxjerrjen e Ligjit përkatës për pagat e funksionarëve të lartë publik.

Afati i konkursit është i hapur 30 ditë nga data e publikimit.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Member of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo
Mr. Pror. 738 | Nr. i Fax: | Br. str. 1 | Data: |
Broj prot. | Br. str. |
Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskoh sestrara, babica i ostalih zdravstvenih struonjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

Mbështetur në Vendimin e Këshillit Drejtues 30.10.2020 Kryetari i OIK shpall:

FTESË PUBLIKE PËR AUDITIMIN E JASHTËM TË VEPRIMTARISË DHE PASQYRAVE FINANCIARE TË OIK-UT

Ftojme kompanitë audituese të licencuar nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (KKRF), që të paraqesin ofertat e tyre për: **Auditimin e veprimtarisë dhe pasqyrave financiare të Odës së Infermierëve të Kosovës për vitin 2019.**

Objektivat dhe fushëveprimi i punës:

Qëllimi i auditimit të veprimtarisë së OIK-ut është që të mundësojë auditorin të shprehë një opinion profesional mbi veprimtarinë dhe pozicionin financiar mbi të ardhurat dhe shpenzimeve për periudhën kontabël. Auditimi do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtarë të Auditimit (ISA) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC). Këto standarde kërkojnë që auditori të planifikojë dhe kryejë auditimin për të marrë siguri të arsyeshëm në lidhje me atë nëse pasqyrat financiare nuk janë të pavërteta. Auditimi përfshin shqyrtimin, në bazë të testimit, të provave që mbështesin shumat dhe shpalesjet në pasqyrat financiare. Kjo gjithashtu përfshin vlerësimin e parimeve të përdorura të kontabilitetit dhe vlerësimeve të rëndësishme të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ofertat e paraqitura duhet të përmbajnë:

- Auditori duhet të jetë një kompani ligjore dhe kredibile e auditimit;
- Auditori duhet të jetë krejtësisht i paanshëm dhe i pavarur;
- Përvojat në auditimin e institucioneve të tjera të ngjashme me OIK;
- CV- të dhe referencat për stafin dhe përvojat e tyre dhe
- Ofertën financiare

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet pranë zyrave të OIK-ut në formë fizike nga ora 09:00 deri në ora 14:00.
Afati i aplikimit është 7 ditë pune nga data e publikimit në webfaqen e OIK-ut, <http://oik-ks.org/>.

Data e publikimit:
02.12.2020

Kryetari i OIK-ut
Naser Rusternaj



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Punëve të Brendshme
 Ministarstvo Unutrašnjih Poslova - Ministry of Internal Affairs

KONKURS

Na osnovu člana 14. Zakona br. 05/L - 085 o električnoj energiji, Ministarstvo Unutrašnjih Poslova objavljuje konkurs za ovo radno mesto:

Naziv radnog mesta:

Direktor odbora operatera prenosnog sistema-
 Za predstavnik iz ne-većinskih zajednica

KVALIFIKACIJE I PROFESIONALNA PODOBNOST

Da bi jedan kandidat bio izabran za direktora Odbora u Centralnom javnom preduzeću, mora imati kvalifikacije i radno iskustvo u skladu sa članom 17. Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087, i člana 9. Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, i to:

- Da ima najmanje pet (5) godina radnog iskustva na visokom nivou upravljanja u sledećim oblastima:
 - u poslovnoj administraciji;
 - korporativnim finansijama;
 - javnim finansijama;
 - upravljanje trezorom;
 - banke;
 - poslovnim konsultacijama;
 - industriji ili
 - da je radio najmanje 5 godina kao ovlašćeni računovođa, kvalifikovani pravnik, ili kvalifikovani član bilo koje druge profesije koja je povezana za poslovnu delatnost Centralnih javnih preduzeća.

U slučaju velikog broja aplikacija, sledeći poželjni kriterijumi biće korišćeni za procenu aplikacija, pri čemu neuspešni kandidati biće eliminisani u fazi razmatranja biografija u procesu regrutovanja:

Diploma osnovnih studija

Diploma master studija,

Postdiplomske profesionalne kvalifikacije,

Član nacionalno priznatog profesionalnog udruženja

Radno iskustvo u međunarodnim institucijama/projektima,

Radno iskustvo na položaju izvršnog direktora,

Sposobnost da tečno govori i piše jedan strani jezik.

USLOVI

Osoba nema pravo vršenja funkcije direktora u Odboru centralnog javnog preduzeća, ukoliko je:

- Bio osuđen ili je pod istragom nadležnog suda;
- Prekršio etički kodeks ili standarde profesionalnog ponašanja, osim ako je ta kazna preinačena od strane suda ili drugog žalbenog organa;
- Lažno svedočio pod zakletvom;
- Bio na rukovodećoj funkciji u kompaniji koja je bankrotirala tokom poslednjih deset (10) godina.
- Ne radi u bilo kojoj instituciji koja kreira razvojne politike za Javna preduzeća kod kojih kandidat aplicira.

Kandidat ne može biti izabran za direktora Odbora centralnog javnog preduzeća, ukoliko je:

- Trenutno je službenik, menadžer dotičnog Javnog preduzeća, (u smislu člana 21. Zakona o javnim preduzećima), ili bilo koje od njenih filijala;
- Služio kao službenik ili menadžer dotičnog Javnog preduzeća, ili bilo koje od njenih filijala, tokom proteklih pet (5) godina;
- Trenutno, ili tokom proteklih tri godina, se nalazi u bilo kakvim materijalnim poslovnim odnosima (osim kao individualni korisnik usluga Javnih preduzeća) sa dotičnim Javnim preduzećem ili bilo kojom od njenih filijala, bilo da je to direktno ili indirektno;
- Akcionar, direktor ili službenik u privrednom društvu ili drugom pravnom licu, koji ima materijalne poslovne odnose sa dotičnim Javnim preduzećem ili bilo kojom od njenih filijala;
- Prima, ili je primao tokom prethodne tri (3) godine, dodatnu kompenzaciju od dotičnog Javnog preduzeća ili od bilo koje od njenih filijala (osim honorara za direktora ili stimulativne kompenzacije utvrđene članom 20.1 Zakona o javnim preduzećima), ili je član penziona šeme dotičnog javnog preduzeća ili bilo koje njene filijale;
- Predstavlja akcionara koji poseduje više od deset odsto (10%) akcija sa pravom glasa u dotičnom Javnim preduzećem;
- Služio u Odboru direktora dotičnog Javnog preduzeća više od devet (9) godina od datuma njegovog/njenog prvog izbora;
- Rođak u trećem kolenu (kao što je utvrđeno u skladu sa definicijom "Finansijskog interesa" u članu 2. Zakona o javnim preduzećima) bilo koje osobe koja pripada nekoj od gore navedenih kategorija.
- Službenik, direktor ili akcionar, ili ima finansijski interes u privrednom društvu koje konkuriše sa Preduzećem, ili je viši menadžer, službenik, direktor ili akcionar (koji poseduje više od dva odsto (2%) prava glasa), ili ima značajan finansijski interes u bilo kom od privrednih društva koja konkurišu sa Preduzećem;
- Trenutno, ili u bilo kom trenutku tokom perioda od 36 meseci pre datuma apliciranja, bio je javno izabrani zvaničnik, politički imenovan ili nosilac rukovodeće funkcije ili donosilac odluka u političkoj stranci;
- Ima bilo kakav sukob interesa koji bi po prirodi prouzrokovao da ova osoba ne bude u stanju da rutinski, pouzdano, nezavisno i objektivno ispunjava svoje finansijske obaveze prema akcionarima i javnim preduzećima.

POTREBNE LIČNE SPOSOBNOSTI

- Liderstvo

- Timski rad
- Korišćenje interneta
- Strateško razmišljanje
- Orijetisanje na rezultate
- Odlučivanje
- Uticajne sposobnosti
- Jasnu koherentnost, koncizna komunikacija
- Integritet
- Svest
- Kreativno razmišljanje

TRAJANJE MANDATA:

Mandat svakom članu Odbora traje četiri (4) godine, uz mogućnost imenovanja na još jedan mandat. Mandat svakom članu Odbora počinje od dana imenovanja od strane Skupštine Republike Kosovo.

OPŠTE INFORMACIJE ZA KANDIDATE O PROCEDURAMA ZA KONKURISANJE

Kandidati za direktore u Odboru javnog preduzeća moraju dostaviti sledeća dokumenta (Neuspeh dostavljanja sledećih dokumenata rezultiraće odbacivanjem aplikacije):

- Biografija u kojoj su navedeni primeri uspeha u radu
- Motivaciono pismo
- Izjavu pod zakletvom (obrazac koji se popunjava u trenutku podnošenja dokumentacije)
- Dokumentacija predviđena prema uslovima za zapošljavanje (potvrde o profesionalnoj kvalifikaciji, radnom iskustvu)
- Sertifikat (potvrdu) koji dokazuje da nije pod istragom
- Državljanin Kosova (kopiju pasoša ili lične karte).

Podnosilac aplikacije mora lično popuniti izjavu pod zakletvom prilikom apliciranja, u kojoj izjavljuje da on/ona ispunjava uslove kvalifikacije, nezavisnosti i profesionalne podobnosti. Svako materijalno lažno predstavljanje, bilo da je to namerno ili nenamerno, ili materijalna promena od datih informacija u gore navedenoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

Dokumentacija treba da bude dostavljena u zapečaćenoj koverti na kojoj treba napisati ime i prezime kao i naziv Javnog preduzeća u kojoj kandidat konkuriše i dostaviti Ministarstvo Unutrašnjih Poslova, kadrovskoj službi, kancelarija br. 320, sprat III, zgrada Palate štampe, Priština, ili putem elektronske pošte na linku: <http://map.rks-gov.net>
 Dostavljena dokumentacija se ne vraća. Originali su potrebni tokom intervjuja.

Za dodatne informacije pozovite na broj telefona 038/ 200 30 185.

Biće kontaktirani samo kandidati koji su izabrani za intervju.

Iznos za naknadu članova Odbora utvrđuje Skupština do donošenja odgovarajućeg Zakona o platama visokih javnih funkcionera.

Konkurs je otvoren 30 dana od dana objavljivanja

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► N.T.SH. "Plus Travel" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70781379.

► "Novara" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810837198.

► "Trend Shped" SH.P.K. shpall të pavlefshme dokumentet e biznesit me nr. 810041591.

► Qendresa Bobaj shpall të pavlefshme dëftesat shme " Ymer Prizreni " Prizren.

► Syle Shala shpall të pavlefshme 3 dëftesat shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Leutrim Puka shpall të pavlefshme dëftesën e vitit X shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Driton Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Lindor Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras,

banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



Kur fakti politik bëhet pjesë e historisë, e ne e vëzhgojmë atë me një distancë të ftohtë, Xhevdet Bajraj na e shpërndan atë të konvertuar në një fabul të shkëlqyer *Cuando el hecho político pasa a formar parte de la Historia, y lo observamos con fría distancia, Xhevdet Bajraj nos lo entrega convertido en una espléndida fábula*

Héctor Carreto, poet, meksikan. - *Poeta mexicano*

Imazhet që ai evokon janë të pastra dhe të bukura, me pak njerëz, si plagë të thella e të pastra. Kur përktheja këto imazhe unë u përpoqa ta kap pafajësinë e tyre, bukurinë e tyre fëmijërore, e cila bie kaq shumë në kontrast me makthe të errëta të kujtesës së Bajrajt

Las imágenes que evoca son limpias y hermosas, con poca gente, como heridas profundas y limpias. Al traducir estas imágenes, intenté capturar su inocencia, su belleza infantil, que contrastan de manera tan marcada con las oscuras pesadillas de la memoria de Bajraj

Alice Whitmore, përkthuese e poezisë së Bajrajt nga gjuha spanjolle në angleze, Australi. - *Traductora de la poesía de Bajrajt del español al inglés, Australia*

Zëri që na detyron t'i modifikojmë kategoritë tona dhe referencat ndaj dhunës, tmerrit, vdekjes, braktisjes, vetmisë, e cila në këtë Amerikën tonë Latine (kaq e prirë për të shpallur dhimbje që nga heroina e romantizmit) ka qenë pretext i poezisë pamfletuese të oportunitizmit lirik

Voz que nos obliga a modificar nuestras categorías y referencias para con la violencia, el horror, la muerte, el abandono, la soledad, que en esta nuestra Latinoamérica (tan proclive a anunciar el dolor desde la heroína del romanticismo) ha sido pretexto de pamphletarias poesías de oportunismos líricos

Carlos Pineda, poet dhe eseist meksikan. - *Poeta y ensayista mexicano*

Poezia e Xhevdet Bajrajt nxit stuhi asociacionesh të lexuesi, e shkëput atë nga realiteti trivial dhe e strehon në një realitet të ri ku mbretëron meditimi për çështje substanciale të jetës, për botën, vetminë, dhimbjen dhe rrugëtimin e njeriut në jetë

La poesía de Xhevdet Bajrajt estimula la tormenta de asociaciones en el lector, lo separa de la realidad trivial y lo cobija en una nueva realidad donde reina la meditación sobre cuestiones sustanciales de la vida, sobre el mundo, la soledad, el dolor y el viaje del hombre en la vida

Zyrafete Shala, kritike letrare. - *Crítica literaria*

Poezi e dinjitetit mbi gërmadha. - *Poesía de dignidad sobre ruinas.*
Shqiptar Oseku, poet. - *Poeta*

6⁹⁹ €KAFE ME NËNËN
CAFÉ CON MAMÁ

XHEVDET BAJRAJ



XHEVDET BAJRAJ

KAFE ME NËNËN poeziCAFÉ CON MAMÁ poesia

Parathënien/Prólogo: Adil Olluri



Adem Gashi (1953), poet, prozator dhe eseist, pa lënë mënjanë njohuritë e paskajshme të tij për letërsinë shqiptare dhe për atë botërore, ka kryer studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Universitetin e Prishtinës. Ka punuar mësues dhe ka qenë redaktor reviste, drejtor televizionit, themelues i PEN-it të Kosovës, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, bursist i fondacionit gjerman "Heinrich Böll-Stiftung", këshilltar i lartë politik, drejtor i Zyrës për Komunikim në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Është anëtar i revistës *Akademia* dhe anëtar i Këshillit Drejtues i Institutit Albanologjik. Ka botuar 24 libra dhe është nderuar me rreth 50 çmime letrare. Është prezantuar në dhjetë antologji të lirikës shqipe. Edhe pse që dy vjet ka mbushur moshën e pensionistit, krijimtarinë letrare s'ka ndërmend ta pensionojë.

Libri i katërt me tregime, me rrëfenja e me parabola i Adem Gashit, *Lakorja e fatit*, dëshmon dhe ridëshmon autorin si krijues po aq të fuqishëm edhe në prozë. Madje tani mund të vlerësohet se toka e begatë e shkrimtarit, në kuptimin cilësor të vlerave artistike dhe të hijeshisë dhe të kënaqësisë estetike, është tregimtaria.

Lakorja e fatit çilet me tregimin uverturë *Pëllumbi i paqes* i rimarrë nga libri me titullin omonim (*Pëllumbi i paqes*, 1989), për të lakuar strukturalisht tre kapitujt pasues: *Terr*, *Dritë dhe mjegull* dhe *Matanë*, të cilët, në aspektin e konceptimit mbarështrues të tyre, na e vizatojnë kurbën tematike dhe motive, ideore dhe përmbajtjesore, filozofike dhe psikanalitike jo vetëm të rrëfimitarëve tregimtarë, por edhe të gjenit krijues të autorit. Në këtë rast, besoj, vlen të veçohen dy aspekte: poetika moderniste me elemente të postmodernizmit dhe gërshetimi i formave dhe zhanreve letrare siç, fjala vjen, i prozës (tregimi, rrëfenjat), i poezisë (një lirikë me dy parabola poetike dhe një rrëfenjë-parabolë) si dhe i dramës, i konceptuar në trajtë të antidramës (*Maja e gishtit të madh të perandorit*).

4⁹⁹ €

Dr. Emin Z. Emini

LAKORJA E FATIT

ADEM GASHI

ADEM GASHI

LAKORJA E FATIT
(Tregime, rrëfenja dhe parabola)